

Raporti Vjetor 2012

NLB  Prishtina



PËRMBAJTJA

1. TË DHËNAT KYÇE FINANCIARE	4
2. DEKLARATA E KRYETARIT TË BORDIT UDHËHEQËS	5
3. MENAXHMENTI I NLB PRISHTINA	6
4. REZYME E SHKURTËR	7
5. AMBIENTI MAKROEKONOMIK	8
6. STRATEGJIA	11
6.1. Vlerat, Visioni dhe Misioni	11
6.2. Objektivat Strategjike	11
7. QEVERISJA KORPORATIVE	13
7.1. Qeverisja Korporative dhe Organet Menaxhuese	13
7.2. Kapitali aksionar dhe struktura e kapitalit	15
7.3. Auditimi i Brendshëm	16
8. RISHIKIMI FINANCIAR	18
8.1 Bilanci i gjendjes - rishikim	18
8.2 Bilanci i Suksesit - rishikim	20
9. AKTIVITETET SIPAS SEGMENTEVE BIZNESORE	23
9.1 Korporatat	23
9.2. Biznesi retail	24
9.3. Thesari dhe Pagesat	26
9.4. Teknologjia Informative	28
10. MENAXHIMI I RISKUT	30
11. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	33
12. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT	34
13. ADRESAT DHE KONTAKTET	118

1. TË DHËNAT KYÇE FINANCIARE

	Aktuali	Aktuali	Aktuali	Plani vjetor	Indeksi	Indeksi
000 EUR	31.12.2010	31.12.2011	31.12.2012	31.12.2012	31.12.2012 / 31.12.2011	31.12.2012 / Plan
Koeficientët kryesor						
ROE pas tatimit	12.8%	12.10%	11.2%	11.1%		
ROA pas tatimit	1.3%	1.20%	1.1%	1.1%		
Raporti të hyra/shpenzime (CIR)	62.5%	60.7%	62.1%	58.4%		
Gjithsejtë rritja e asetëve	9.9%	9.9%	9.6%	2.7%		
Indikatori i mjaftushmerisë së kapitalit (BQK)	16.3%	16.5%	13.5%	13.5%		
Marzha kamatore	4.0%	3.9%	3.5%	4.1%		
Pjesëmarrja në treg me gjithsejtë Mjetet	15.1%	15.5%	16.0%	15.0%		
Bilanci i Suksesit						
Neto fitimi për vitin financiar	4,226	4,358	4,523	4,500	104%	101%
Fitimi para tatimit	4,585	5,376	5,066	5,000	94%	101%
Gjithsejtë të hyrat	17,943	17,823	17,862	19,600		
Neto të hyrat kamatore	13,923	14,008	14,142	15,800	101%	90%
Neto të hyrat jo-kamatore	3,571	3,441	3,404	3,400	99%	100%
Shpenzimet operative	-11,221	-10,812	-11,086	-11,450	103%	97%
Provizionet & zhvlerësimet	-1,634	-1,590	-1,708	-3,150	107%	54%
Bilanci i Gjendjes						
Gjithsejtë Mjetet	351,554	386,459	423,476	396,500	110%	107%
Rangimi në Gjithsejtë Mjetet	3	3	3	3		
Gjithsejtë Mjetet për punëtor	732	732	801	736		
Bruto kreditë (SJB)	204,004	227,435	255,255	265,000	112%	96%
Kreditë ndaj sektorit jo-bankar (Neto)	185,984	208,298	234,138	242,500	112%	97%
Pjesëmarrja në treg me kredi (SJB)	14.6%	13.20%	14.5%	15.0%		
Depozitat e sektorit jobankar	296,449	330,045	367,217	335,000	111%	110%
Pjesëmarrja në treg me Depozita SJB	15.2%	15.50%	16.3%	15.0%		
Totali i mjeteve të peshuara me rrezik	237,314	237,104	247,836			
Kapitali i klasit 1 sipas BQK	34,510	36,596	37,187	39,198	100.8%	94.9%
Kapitali Aksionar	33,863	38,205	42,974	42,750	113%	101%
Kualiteti i Portofolios						
Provizionet dhe rezervat për riskun kreditor BGJ	-19,038	-21,160	-23,239			
Portofolio kreditore	343,037	375,005	355,821	390,600		
Mbulesa e portofolios me provizione	5.6%	5.60%	6.5%	5.9%		
Kreditë jo-performuese	14,500	14,184	17,207		121.3%	
Mbulesa e kredive jo-performuese me provizione	130 %	140 %	127 %	133 %		
Kreditë jo-performuese në gjithsejtë kreditë	4.8%	3.8%	5.5%			
Kreditë e JSB/Depozitat e JSB (LTD)	62.7%	63.1%	63.8%	72.4%		
Burimet						
Numri i të punësuarve	533	528	529	539	100%	98%
Numri i degëve	9	9	9	9	100%	100%
Numri i klientëve	214,521	234,741	261,534			

2. DEKLARATA E KRYETARIT TË BORDIT UDHËHEQËS



Viti 2012 ka qenë një nga vitet më të mira të afarizmit të NLB Prishtina që nga prezenca e bankës në tregun bankar të Kosovës, të gjitha objektivat e rritjes ishin realizuar ose tejkaluar dhe përmirësimet në shumicën e treguesve kyç të performancës janë arritur. Në përputhje me rrethanat, pjesëmarrja jonë në treg ka shënuar rritje në të gjitha segmentet e biznesit dhe banka ka arritur sukses në ruajtjen e pozicionit si banka e tretë më e madhe jo vetëm në aspektin e aseteve dhe të depozitave, por edhe në kredi. Ne kemi vazhduar t'i shërbejmë të gjitha kategoritë e klientëve dhe ju kemi ofruar atyre shërbim të cilësisë së lartë. Për shkak të fuqisë financiare ndërkombëtare dhe rritjes së NLB Group klientët tanë përfitojnë nëpërmjet transferimit dhe qasjeve të know-how, stabilitetit, dhe lidhjeve në mbarë botën.

Në vitin 2012 totali i aseteve të bankës është rritur me 9.6% dhe ka arritur shumën prej 423 milion euro, duke tejkaluar planin me 6.8%. Depozitat e sektorit jo-bankar janë rritur me 11.3% dhe kanë arritur në 367 milion euro. Neto kreditë e sektorit jo-bankar kanë arritur shumën prej 234 milion euro në fund të vitit dhe janë rritur për 12.4% krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Edhe pse cilësia e portofolit të kredisë është në të njëjtin nivel në krahasim me vitet e mëparshme, banka kishte qasje konservative për krijimin e provizioneve për humbje nga kreditë.

Vlen të theksohet se rritja ka qenë sistematike dhe e kontrolluar, siç dëshmohet nga auditorët e BQK-së dhe auditorët e jashtëm. Ekzaminimi i BQK-së nuk ka identifikuar ndonjë problem serioz dhe ka vlerësuar bankën me vlerësimin më të lartë CAMEL në industrinë financiare të Kosovës. Si rezultat i strategjisë sonë të rritjes së kujdesshme, NLB Prishtina ka përmbushur të gjitha objektivat e përcaktuara në planin e biznesit në aspektin e profitabilitetit, ka realizuar një fitim pas tatimit në shumë prej 4.5 milion euro sipas standardeve ndërkombëtare dhe vendore që korrespondon me kthimin në ekuitet prej 11.2% dhe kthimin në asete prej 1.1%. Një vëmendje e madhe i është kushtuar edhe ruajtjes së pozicionit të mirë të Bankës në aspektin e likuiditetit dhe indikatorëve të adekuatshmërisë së kapitalit në vitin 2012, duke e ulur profilin e rrezikut të bankës dhe përmirësimin e efikasitetit të kostos.

Në të njëjtën kohë me arritjen e objektivave tona, ne kemi prezantuar edhe produkte dhe shërbime të reja dhe jemi duke vazhduar drejtimin e investimeve tona drejt kanaleve të cilat plotësojnë më mirë nevojat e klientëve tanë, e cila është një pjesë kyçe e ruajtjes së besimit të tyre. NLB Prishtina është e gatshme për të përkrahur klientët e saj në të gjitha segmentet, duke mbështetur projekte të personave fizik, NVM-ve dhe korporatave.

Ne jemi të drejtuar nga një vetëdije e fortë e përgjegjësisë sonë së përbashkët dhe shoqërore. Në vitin 2012 Banka ka vazhduar përfshirjen aktive dhe përkrahje në fushën e sportit, artit, kulturës, si dhe aktiviteteve sociale.

Në vitin 2013, duke pasur parasysh sfidat dhe të papriturat e mjedisit ekonomik dhe financiar, rritja e pjesëmarrjes në treg dhe rritja në përgjithësi nuk do të jenë qëllimi ynë kryesor, banka do të jetë e fokusuar më shumë në cilësi se sa në vëllim.

Së fundi, ne dëshirojmë të shprehim falënderimet tona të singerta për të gjithë punonjësit tanë të përkushtuar, Bordin e Drejtorëve për mbështetjen dhe udhëzimet e tyre profesionale, aksionarët dhe klientët për besimin dhe mbështetjen e tyre.

Albert Lumezi,

Kryetar i Bordit Udhëheqës

3. MENAXHMENTI I NLB PRISHTINA



4. REZYME E SHKURTËR

NLB Prishtina është banka e tretë më e madhe në tregun e Kosovës. NLB Prishtina është themeluar nga bashkimi i dy bankave NLB BRK dhe NLB Kasabank më 1 janar 2008. NLB Prishtina ofron shërbime bankare dhe shërbime financiare, si dhe ofron shërbime të kualitetit të lartë për klientët e saj në tregun bankar të Kosovës.

Banka ushtron veprimtarinë e vet bankare në të gjitha qytetet e mëdha të Kosovës. Më 31.12.2012 kishte gjithsejtë 51 njësi, prej tyre 9 filiale.

NLB Prishtina funksionon si një bankë universale, e cila ofron një portofolio të gjerë të shërbimeve bankare për të përmbushur nevojat e klientëve fizik dhe juridik. Ekspertët tanë bankar dhe stafi tjetër profesional janë të përkushtuar për të përmirësuar pozitën tonë në treg, duke u kujdesur me përgjegjësi për nevojat e klientëve tanë, aksionerët, punonjësit dhe komunitetin e gjerë.

NLB Prishtina operon si një bankë komerciale që ofron shërbime të ndryshme.

Banka me 31 dhjetor 2012 kishte 529 punonjës që janë në shërbim të më shumë se 261 mijë klientëve fizik dhe atyre juridik. Aksionar kryesor i NLB Prishtina është NLB d.d. që mban 81.21% të gjithsejtë kapitalit aksionar, ndërsa pjesa tjetër prej 18.71% janë firma private dhe persona fizik.

Totali i aseteve me 31 dhjetor 2012 ishte 423 milionë euro.

NLB Prishtina është anëtare e NLB grup - organizata më e madhe financiare në Slloveni. e cila ofron shërbime bankare si dhe shërbime të tjera financiare, sigurime, menaxhim i aseteve, lizingu, faktoringu dhe konfiskime, dhe operon në shumë vende si: Slloveni, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Kroaci, Gjermani, Itali, Austri, Republikën Çeke dhe Zvicër.

5. AMBIENTI MAKROEKONOMIK

Aktiviteti ekonomik në vend gjatë vitit 2012 u konsiderua si stabil, duke marrë parasysh burimet kryesore të financimit, shumica e të cilave kanë treguar performancë të mirë, dhe në krahasim me vitin e kaluar ishte shënuar një ngadalësim. Megjithatë, kriza në ekonomitë e disa vendeve të eurozonës ka rezultuar në një reduktim të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, të hyrave nga jashtë dhe investimet e huaja direkte të cilat në vitet e mëparshme kanë treguar rezultate më të mira.

Ekonomia e Kosovës vazhdon të karakterizohet nga një deficit i lartë tregtar dhe shkallë të lartë të papunësisë e cila përfaqëson sfidën kryesore për stabilitetin ekonomik dhe social në vend, si dhe shkakun për deficitin e lartë të llogarisë rrjedhëse në vend.


Bruto Produkti Vendor (BPV) i Kosovës shënoi një rritje reale prej përafërsisht 3.8% në 2012 (5 % në vitin 2011). Në terma nominal, BPV ka tejkaluar shumë prej 4.7 miliard euro.

Indikatorët e zgjedhur ekonomik (në përqindje, përveç nëse tregohet ndryshe)

000 EUR	2008	2009	2010	2011	2012
Norma reale e rritjes					
BPV	6.9	2.9	3.9	5	3.8
BPV për banor	5.6	1.4	2.4	3.4	1.1
Konsumi	4.3	1	2.9	2.9	2.0
Investimet	18.1	11.7	8.8	7.6	4.4
Papunesia (përqindja e fuqisë punëtore)	47.5	45.4	45.1	...	
Ndryshimet në çmime					
IÇK mesatarja e periudhës	9.4	-2.4	3.5	7.3	2.5
IÇK fundi i periudhës	0.5	0.1	6.6	3.6	3.8
Çmimet e importit	11.8	-4.9	3.2	7.7	1.8
Vlerat nominale					
BPV (milion euro)	3,851	3,912	4,216	4,637	4,885
BPV për banor (euro)	2,323	2,325	2,468	26,674	2,776
Popullata (mijë)	1,658	1,683	1,708	1,734	1,760

Burimi : raportet e fundit të FMN-së dhe BQK-së deri më 29, Prill, 2013..

BPV për banor të Kosovës vazhdon të jetë më i ultë në krahasim me vendet tjera të regjionit tonë. BPV për kokë banori në Kosovë është rreth 2,700 euro për vitin 2012. Në këtë ka ndikuar kryesisht të hyrat nga jashtë, shpenzimet e larta të qeverisë dhe rritja e kredive të shpërndara nga bankat në Kosovë.



Inflacioni - Bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK), inflacioni në Kosovë ka shënuar një normë mesatare prej 2.5 % në vitin 2012, krahasuar me mesataren prej 7.3% në vitin 2011. Burimi kryesor i presioneve inflacioniste vazhdojnë të jenë çmimet e produkteve të importuara si ushqimet, derivatet, që pasqyrojnë çmimet në ekonominë globale.

Bilanci tregtar - Kosova ka vazhduar të ketë një deficit të madh tregtar, me një normë më të ulët të mbulimit të eksportit / importit në rajon, Ky deficit është financuar kryesisht përmes ndihmës së huaj dhe të remitancave nga diaspora e Kosovës.

Investimet e huaja direkte (FDI) – kanë paraqitur një komponent të rëndësishëm të investimeve në Kosovë edhe gjatë vitit 2012. Kështu, viti 2012 u karakterizua me një nivel të ulët të investimeve në krahasim me vitin e kaluar. IHD sipas dates 30 shtator 2012 kanë arritur shumën prej EUR 167 milione euro, krahasuar me të njëjtën periudhë , një zvogëlim prej 41.3%, që paraqet një zvogëlim të konsiderueshëm.

Sistemi Bankar

Sistemi bankar më 31 dhjetor 2012, u përfaqësua nga tetë (8) banka, të cilat llogariten të zotërojnë më shumë se 75 për qind të totalit të aseteve të sistemit financiar dhe rreth 60 % e BPV-së. Më 31 dhjetor, 2012 totali i aseteve i sektorit bankar arriti në rreth 2,6 milion euro, ku NLB Prishtina është e treta me totalin e mjeteve prej 16%. Me datë 31, Dhjetor 2012, sistemi bankar kishte gjithsejtë 3,682 të punësuar.

Gjatë vitit 2012, sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të rritet dhe të ruajë qëndrueshmërinë e likuiditetit, profitabilitetit dhe adekuatshmërisë së kapitalit. Rritja e sistemit bankar në vitin 2012 ishte më modeste se sa në vitet e mëparshme. Struktura e aseteve ka vazhduar të financohet kryesisht nga depozitat dhe u përqendrua në aktivitetin e kreditimit.

Ngadalësimi ekonomik ka pasur një ndikim mbi cilësinë e kredisë dhe profitabilitetin e bankave, por sistemi bankar ende shfaqet në mënyrë adekuate i kapitalizuar dhe likuid, por gjatë vitit 2012 disa banka kanë performuar edhe me humbje.



Më 31, Dhjetor 2012, vlera totale e mjeteve të sistemit bankar kishte arritur vlerën e përafërt prej 2.6 miliard euro, ku NLB Prishtina vazhdoi që të jetë banka e tretë më e madhja në vend me gjithsejtë mjetet, depozita dhe kredi. NLB Prishtina gjatë vitit 2012, ka regjistruar rritjen më të madhe krahasuar me mesataren e sistemit bankar në zërat kryesor të bilancit të gjendjes.

Sektori bankar për fund vitin 31, Dhjetor 2012 në EUR' mil (Raportimi sipas standardeve lokale)



	Gjithsejtë Mjetet		Neto Kreditë		Depozitat		Fitimi neto		Rritja e Gjithsejtë Mjeteve 2012	Rritja e kredive neto 2012	Rritja e Dpozitave 2012
	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011			
NLB Prishtina	424	387	233	207	362.6	326	4.5	4.4	10%	12.4%	11%
Sektori tjetër bankar	2,170	2,117	1,358	1,355	1,870	1,773	14.1	31.5	2.5%	0.2%	5.5%
Gjithsej sistemi bankar	2,594	2,504	1,591	1,562	2,232	2,099	18.6	36.0	-	-	-

Shënim: Të dhënat e vitit 2012 nuk janë të dhëna finale dhe zyrtare dhe nuk përfshijnë të dhënat e Komercialna Banka.

NLB Prishtina merr pjesë në tregun bankar me gjithsej me rreth 16% me datën 31,dhjetor 2012 të gjithë sistemit bankar.në Kosovë.



Ndërsa pjesa e tregut sipas gjithsejtë depozitave më 31,Dhjetor 2012, është rreth 16% e sistemit bankar ndërsa me neto kreditë afërsisht 14.5%



6. STRATEGJIA

6.1. Vlerat, Visioni dhe Misioni

Vlerat mbi të cilat vizioni dhe misioni i NLB Prishtina janë të bazuara janë siguria, besueshmëria, orientimi ndaj klientëve, cilësia, ekspertiza, dhe qasja proaktive dhe e orientuar ndaj qëllimit kryesor.

Vizioni i NLB Prishtina është që të bëhet një ndër bankat lidere, dhe e besueshme kundrejt rreziqeve të supozuara. Qëllimi kryesor për periudhën e ardhshme afat-mesme është që të siguroj një balansim në mes të profitabilitetit, efikasitetit të kostos dhe mbajtjes së pozitës në treg.

Misioni i NLB Prishtina është që të jetë një partner afatgjatë i besueshëm për klientët e vet.

NLB Prishtina ju siguron klientëve të vet shërbime të klasës së parë, produktet të plota bankare dhe zgjidhje gjithëpërfshirëse financiare që ata kërkojnë për të përmbushur qëllimet e tyre dhe respekton plotësisht kushtet dhe nevojat lokale.

6.2. Objektivat Strategjike

Objektivat strategjike të NLB Prishtina janë bazuar në supozimin se është një bankë e pavarur që zhvillon modelin e vet të biznesit në përputhje me objektivat e vendosura nga kompania amë NLB d.d. dhe siguron burimet e nevojshme strategjike për rritjen dhe zhvillimin. Implementimi i tyre, megjithatë, do të përshtatet kur është e nevojshme për të reflektuar kushtet aktuale.

Objektivat kryesore strategjike të biznesit të NLB Prishtina janë:

- Të mbaj pjesëmarrjen aktuale të tregut dhe të përceptohet nga publiku si një nga akterët më të mëdhenj të industrisë bankare
- Të ketë një reputacion të lartë në treg
- Të mbaj bazën tonë të klienteve dhe të arrij/realizoj rritjen e vëllimit të biznesit, si dhe rritjen e të ardhurave
- Përmirësimi i efikasitetit në të gjitha aspektet operative nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm të operacioneve bankare
- Të jetë një urë lidhëse në mes të ekonomisë Sllovene dhe Kosovës dhe vendet ku NLB Grup është prezent
- Menaxhimi aktiv i portofolit të kredisë me një theks të veçantë në zvogëlimin e KJP
- Menaxhimi aktiv i LTD

NLB Prishtina ofron shërbime të plota bankare për klientët e saj.

Shtyllat kryesore strategjike përfshijnë: Aktivitetet bankare me korporata, aktivitetet bankare me persona fizik si dhe Thesari dhe Pagesat.

Masat për arritjen e objektivave strategjike

Ne ndjekim progresin tonë kundër strategjisë sonë për të qenë një nga bankat më të mira

për klientët tanë, duke përdorur një sërë masash të performancës. Përparimi ynë në këto fusha është matur kundrejt një numri të treguesve kryesore financiare dhe jo-financiare të cilat janë të paraqitura në këtë raport. Çdo dobësi kyçe është eliminuar brenda një periudhe kohore nëpërmjet monitorimit tonë të rregullt.

Sfidat kryesore për arritjen e objektivave strategjike mbeten:


- Mjedisi ekonomik: i dobët, këndvështrimi për ekonominë e Kosovës, së bashku me pasiguritë e vazhdueshme ekonomike në Eurozonë.
- Mjedi Rregullator: Pasiguria mundet të ngritët për shkak të ndryshimeve në rregullativën bankare, në veçanti në kërkesat për kapital dhe likuiditet.
- Konkurrenca: Rritja e konkurrencës në treg për kreditim dhe depozita krijon presion të marzhave kamatore

7. QEVERISJA KORPORATIVE

7.1. Qeverisja Korporative dhe Organet Menaxhuese

NLB Prishtina ka një strukturë të qartë organizative që saktësisht përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe organeve të tjera të menaxhimit, të punësuarit e tjerë, si dhe të linjave të kontrollit dhe të kontrollave në kryerjen e detyrave të përditshme.

Struktura organizative e NLB Prishtina është si më poshtë:



Banka menaxhohet nga Bordi udhëheqës dhe mbikëqyrret nga Bordi i Drejtorëve

Organet kryesore të bankës janë:

- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve,
- Bodi i Drejtorëve
- Këshilli i Auditimit
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut
- Bordi udhëheqës i bankës
- Organet tjera operative

Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve e NLB Prishtina mblidhet dhe merr vendime në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, ku ajo miraton vendimet në përputhje me ligjin.

Përgjegjësitë e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të NLB Prishtina janë të përcaktuara me Statut të NLB Prishtina, të cilat janë gjithashtu në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga rregullatori.

Gjatë vitit 2012 janë mbajtur dy mbledhje të përgjithshme të aksionarëve. Mbledhja e parë ishte më 29 mars, 2012, i cili ishte takimi i rregullt i Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve për vitin 2012, ku 92,83% e aksionarëve ishin të pranishëm. Ndër detyrat e tjera të rregullta, në këtë takim të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve u miratuan: Raporti i Auditorit të jashtëm për vitin 2011, Plani Afarist për periudhën 2012-2016, ndryshimet në strukturën e Bordit, caktimi i auditorit të jashtëm për vitin 2012 dhe ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të NLB Prishtina sh.a.

Mbledhja e dytë e Përgjithshme e Aksionarëve u organizua dhe u mbajt më 10 tetor, 2012, ku u miratua statuti i ri NLB Prishtina sh.a. dhe "Rregullorja e re mbi punën e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të NLB Prishtina sh.a." e përgatitur në përputhje me Ligjin e ri.

Bodi i Drejtorëve

Bodi i Drejtorëve zgjedhet nga aksionerët Bankës, në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore e Aksionarëve dhe është përgjegjës për krijimin e politikave të veta, duke përfshirë politikën për menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bodi i Drejtorëve kryen detyrat e veta në përputhje me dispozitat e ligjeve mbi qeverisjen bankare dhe statutin e bankës të NLB Prishtina sh.a.

Bodi i Drejtorëve gjatë vitit 2012 ka mbajtur 5 takime.

Me date 31 Dhjetor 2012, struktura e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NLB Prishtina sh.a. ishte si në vijim:

1. David Benedek, kryetar
2. Miran Vičić, nën-kryetar
3. Jure Peljhan, anëtar
4. Metush Deshishku, anëtar
5. Remzi Ejupi, anëtar
6. Albert Lumezi, anëtar – Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB Prishtina sipas funksionit pa të drejtë vote.

Bordi i Drejtoreve i NLB Prishtina ka themeluar Këshillin e Auditimit ashtu siç është kërkuar nga ligji mbi bankat. Anëtarët e Këshillit të Auditimit me datë 31 Dhjetor 2012 ishin:

- Jure Peljhan, Kryetar
- Andrea Golubič, anëtar
- Sheremet Kukaj, anëtar
- Nataša Veselinovič, anëtar

Bordi Udhëheqës

Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina udhëheq, përfaqëson dhe vepron në emër të Bankës, në mënyrë të pavarur dhe me vetë-përgjegjësi, ashtu siç parashihet me Statutin e Bankës. Kryetari dhe anëtarët emërohen me një mandat prej katër vitesh, dhe mund të riemërohen ose të tëhiqen para skadimit të mandatit në përputhje me Ligjin dhe Statutin e Bankës.

Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina përbëhet nga: z. Albert Lumezi Kryetar i Bordit Udhëheqës, z. Bogdan Podlesnik, anëtar i Bordit Udhëheqës dhe z. Lavdim Koshutova, anëtar i Bordit Udhëheqës.

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të afarizmit të bankës si dhe monitorimin e aktiviteteve të rregullta të Bankës, brenda bankës gjithashtu veprojnë këto këshille/ komitete:

- Këshilli për menaxhimin e Aktivës dhe Pasivës (ALCO)
- Këshilli kreditor
- Këshilli për Menaxhimin e Riskut Kreditor
- Këshilli i Sigurisë
- Këshilli për Menaxhimin e Riskut Operacional
- Komiteti i IT-së
- Këshilli i Personelit
- Këshilli i Prokurimit
- Komiteti i çmimeve
- Komitetit për arkëtimin e kredive të këqija

7.2. Kapitali aksionar dhe struktura e kapitalit

Kapitali aksionar i bankës me datë 31, Dhjetor 2012 përbëhet nga 42,739 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej EUR 479.61 për aksion. Aksionet nominale iu përcaktojnë pronarëve të drejtën mbi pagesën e dividendës dhe të drejtën e votimit në Asamblenë e Përgjithshme. Kapitali aksionar i Bankës aksionar paraqet gjithë kapitalin e paguar aksionar. Totali i kapitalit të regjistruar dhe paguar të bankës është në shumën prej 20,498 mijë euro, ndërsa i gjithë kapitali aksionar është në shumën prej 42,974 mijë euro.

Të gjitha aksionet kanë të drejtë për dividendë dhe kanë të drejta të barabarta vote. Nuk ka kufizime lidhur me aksionet. Një përmbledhje e pronësisë së aksioneve të Bankës është si vijon:

Aksionarët	Përqindja e pronësisë	31, Dhjetor 2012	Përqindja e pronësisë	31, Dhjetor 2011
Nova Ljubljanska Banka d.d	81.21	16,647	81.21	16,647
Agjencioni i Turizmit " MCM"	4.63	949	4.63	949
Familja Deshishku	5.86	1,201	5.86	1,201
Familja Ejupi	4.1	840	4.1	840
Të tjera	4.2	861	4.2	861
	100	20,498	100	20,498

Shënim: shumat janë të paraqitura në EUR '000 mijë

Ndërsa, struktura e gjithsejtë kapitalit aksionarë përbëhet sin ë vijim:

	Kapitali Aksionar	Rivlerësimi i AFS	Fitimi i Mbajtur	Gjithsej
Gjendja më 1, Janar 2011	20,498	10	13,355	33,863
Fitimi i vitit	-	-	4,357	4,357
Të hyrat / humbjet e tjera	-	(16)	-	(16)
Gjendja më 31, Dhjetor 2011	20,498	(6)	17,712	38,204
Fitimi i vitit	-	-	4,523	4,523
Të hyrat/humbjet e tjera	-	247	-	247
Gjendja më 31, Dhjetor 2012	20,498	241	22,235	42,974

Shënim: shumat janë të paraqitura në EUR '000 mijë

7.3. Auditimi i Brendshëm

Sektori i Auditimit të Brendshëm i NLB Prishtina është një njësi e pavarur, e cila ka një rol këshillues të pavarur dhe objektiv, duke përdorur një qasje sistematike dhe profesionale për vlerësimin e menaxhimit të rrezikut, sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e operacioneve të bankës. Auditimi i brendshëm jep një kontribut të rëndësishëm dhe luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e objektivave strategjike dhe afariste dhe praktikrat më të mira bankare.

Metodologjia e punës së auditimit të brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë e saj janë përcaktuar në Statutin e Auditimit, ndërsa udhëzimet dhe procedurat e punës janë të përshkruara në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Të dyja këto dokumente janë plotësisht në përputhje me standardet e Qendrës së Auditimit të Brendshëm në NLB dd, me praktikrat më të mira dhe në përputhje me Ligjin Bankar të Kosovës.

Në vitin 2012, Sektori i Auditimit të Brendshëm i është nënshkruar një rishikimi të kualitetit nga një kompani e pavarur vlerësuese nga BE-ja. Pas vlerësimit të kryer, rezultatet kanë qenë që Shërbimi i Auditimit të brendshëm të NLB Prishtina është në përputhje me Standardet ndërkombëtare për Praktikrat Profesionale të Auditimit të brendshëm, Kodit të Etikës dhe parimeve të Kodit të Auditimit të brendshëm.

Gjatë vitit 2012 auditimi i brendshëm ka punuar në përputhje me Planin e Auditimit të Brendshëm 2012. Bazuar në planin e auditimit janë kryer trembëdhjetë (13) auditime të rregullta, që mbulojnë pjesët kyqe të operacioneve të bankës si riskun kreditor, retailin, korporatat, pastaj edhe auditime të befasishme të degëve, ndërsa në bazë të nevojave dhe kërkesave të tjera janë kryer edhe auditime të jashtëzakonshme. Disa fusha të audituara janë kryer në bashkëpunim me kolegët nga Qendra e Auditimit të Brendshëm të NLB dd.

Auditimi i brendshëm ka monitoruar rregullisht zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Auditimi i Brendshëm, Banka Qendrore e Kosovës dhe Auditimi i jashtëm. Gjendja e rekomandimeve të hapura është raportuar në baza tremujore në Keshillin e Auditimit, Bordin e Drejtorëve dhe Qendren e Auditimit të Brendshëm të NLB dd.

8. RISHIKIMI FINANCIAR


8.1 Bilanci i gjendjes - rishikim

NLB Prishtina ka vazhduar të ketë një performancë të mirë financiare edhe në vitin 2012, duke pasur parasysh një ambient sfidues të vazhdueshëm ekonomik dhe rregullator. Gjatë vitit 2012, banka ka arritur të ketë rritje në fitim dhe të krijoj të hyra të mira nga afarizmi, duke forcuar më tej bilancin e gjendjes dhe zvogëluar kostot dhe riskun. Likuiditeti ynë gjithashtu mbetet i fortë.

Zërat kryesor nga Pasqyra e Gjendjes Financiare

	Aktual	Aktual	Strukturura	Ndryshimi		Plani I vitit	Krahasimi me Planin	
000 EUR	31.12.2011	31.12.2012		2012		31.12.2012		
Paratë e gatshme dhe gjendja me BQK	31,122	61,410	15%	30,288	97%	37,040	24,370	66%
Mjetet financiare në dispozicion për shitje	35,615	58,382	14%	22,767	64%	25,000	33,382	134%
Kreditë e bankave	103,248	57,715	14%	-45,533	-44%	76,300	18,585	-24%
Kreditë e sektorit jo-bankar (Gjithsejtë)	208,298	234,138	55%	25,839	12%	242,500	-8,362	-3%
Kreditë e korporatave	138,917	155,861	37%	16,944	12%	159,300	-3,439	-2%
Kredite e retail	69,381	78,277	18%	8,895	13%	83,200	-4,923	-6%
Mjetet e luajtshme dhe mjetet e paluajtshme	7,600	10,877	2%	3,277	46%	13,110	-2,829	-22%
Mjetet e tjera	575	954	0%	379	142%	1,500	-557	-37%
Gjithsejtë Mjetet	386,459	423,476	100%	37,017	10%	396,500	26,976	7%
Depozitat (gjithsej)	330,410	367,426	87%	37,002	11%	335,400	32,026	10%
Depozitat e bankave	365	209	0%	-156	-43%	400	-191	-48%
Depozitat e klienteve (SJB)	330,045	367,217	87%	37,158	11%	335,000	32,217	10%
Huamarrjet	12,632	8,773	2%	-3,859	-31%	13,800	-5,027	-36%
Detyrimet e tjera	5,213	4,303	1%	-896	-	0	3,763	-
Gjithsejtë Detyrimet	348,255	380,502	90%	32,247	9%	353,750	26,752	8%
Zërat e Ekuitetit, përveq fitimit të vitit	33,847	38,451	9%	4,604	14%	38,250	201	1%
Fitimi I vitit të tanishëm	4,357	4,523	1%	166	4%	4,500	23	1%
Gjithsejtë Ekuiteti	38,204	42,974	10%	4,770	12%	42,750	224	1%
Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti	386,459	423,476	100%	37,202	10%	396,500	26,976	7%

Gjithsej Bilanci i Gjendjes i NLB Prishtina sipas datës 31 Dhjetor 2012 ishte 423,476 mijë euro dhe krahasuar me 31 Dhjetor 2011 ka shënuar rritje për 37,017 mijë euro (apo 10% rritje). Plani vjetor në aspektin e gjithsej mjeteve është tejkaluar për 7 %,




Paraja e gatshme dhe bilanset në bankën qendrore janë rritur për 61,410 mijë euro ose me 30.288 mijë euro në krahasim me vitin e kaluar të cilat kanë kontribuar në likuiditetin e bankës.

Kreditë ndaj bankave më 31 dhjetor 2012 ishin 57,715 mijë euro, dhe janë zvogëluar me 45 milionë euro, për shkak të investimeve në asetet me fitimprurëse si obligacionet qeveritare. Shumica e plasmaneve, janë të plasura me bankat që kanë klasifikimin më të mirë kreditor.

Investimet në letrat me vlerë me datë 31 dhjetor 2012 ishin 58.383 mijë euro, një rritje prej 23 milion euro. Prej shumës totale, shuma e 39 milion euro është investuar në obligacione afatshkurtra të qeverisë Sllovene, 18.9 milion euro në obligacione qeveritare të Kosovës dhe 0.5 milion euro në NLB MontenegroBanka.

Kreditë neto ndaj sektorit jo-bankar në fund të dhjetorit kanë arritur në shumën 234.138 mijë euro, një rritje prej 25.8 milion euro në krahasim me vitin e kaluar apo 12.2%. Kreditë e sektorit jo-bankar janë rritur në të gjitha llojet e kredive të lëshuara. Pjesëmarrja në treg e Bankës në kredi (JSB) në vitin 2012 është rritur përafërsisht në 14.5% të gjithsejt sektorit bankar në Kosovë.




Provizionet për humbjet nga kreditë - banka ka vazhduar të ketë një qasje konservative për krijimin e provizioneve për kredi. Provizionet për kredi në bilancin e gjendjes në vitin 2012 janë rritur për 1.981 mijë euro dhe në fund të vitit arrijnë shumën 21,859 mijë euro gjithsejtë rezervat.


Totali i depozitave të sektorit jo-bankar, me 31.12. 2012 ishte 367,217 mijë euro, që krahasuar me 31.12.2011 paraqet një rritje prej 37.158 mijë EUR (afërsisht 11 %).

Plani vjetor i të gjitha depozitave është arritur 109.6%, duke tejkaluar planin për 32,217 mijë euro. Pjesëmarrja në tregun e depozitave është rreth 16.3%. Struktura e depozitave përbëhet nga 66% që janë depozita të qytetarëve dhe subjektet juridike 34%, ndërsa depozitat e afatizuar - marrin pjesë me 72%.

Depozitat ndaj sektorit-jo bankar



Struktura e depozitave (SJB) 31.12.2012



Huazimet, në fund të vitit arrijnë në 8,774 mijë euro dhe në krahasim me vitin e kaluar është zvogëluar gati rreth 4 milion euro. Nga shuma e përgjithshme, shuma prej 8,200 mijë euro është huamarrja nga EFSE dd dhe 0.5 milion EUR nga NLB d.d. Banka është mjaft likuide dhe nuk do të ketë nevojë për huamarrje nga institucionet e tjera, pasi që financiarisht është mjaft stabile. Qëllimi i huamarrjes nga EFSE është për të rifinanciar nën-kredi për huamarrësit në Kosovë për aktivitetet e banimit dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME).

Kapitali aksionar bazuar ne SNRK sipas 31 dhjetor 2012 ishte 42,974 mijë euro.

Kapitali i bankës është rritur në mënyrë organike gjatë viteve përmes kapitalizimit të fitimit të pashpërndarë.

Ndërsa sipas standardeve lokale gjithsej kapitali aksionar është prej 41,709 mijë euro, ndërsa vetëm fitimi i vitit 2012 është në shumën prej 4,506 mijë euro.

8.2 Bilanci i Suksesit - rishikim


NLB Prishtina në vitin 2012 ka gjeneruar **fitim para tatimit** në shumën prej 5,066 mijë euro, ndërsa fitimi pas tatimit ishte 4,523 mijë euro. Plani me neto fitim është arritur prej 100.4%, ndërsa në vlera nominale është rritur në shumën prej 165 mijë euro krahasur me vitin e kaluar.

Të hyrat neto nga interesi, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të të hyrave, përbëjnë shumën prej 14,142 mijë euro për vitin 2012, një rritje prej 134 mijë euro krahasuar me vitin e kaluar. Pjesa më e madhe e të hyrat gjenerohet nga kreditë nga tregu vendor Kosovar, dhe krizat e ndodhura në Eurozonë nuk ka pasur ndonjë efekt madhor në rezultatet e bankës.

Zërat kryesor nga bilanci i suksesit

000 EUR	Aktual 1.1.-31.12.2011	Aktual 1.1.-31.12.2012	Plani i vitit 1.1.-31.12.2012	Krahasimi me Aktualin Aktual 1.1.-31.12.2011	
Të hyrat nga interesi	25,045	26,533	27,700	1,488	6%
Shpenzimet e interesit	-11,037	-12,391	-11,900	-1,354	12%
Të hyrat neto nga interesi	14,008	14,142	15,800	134	1%
Të hyrat neto nga komisionet dhe provizionet	3,441	3,404	3,400	-37	-1%
Të hyrat nga komisionet dhe provizionet	4,371	4,374	4,500	3	0%
Shpenzimet nga komisionet dhe provizionet	-930	-970	-1,100	-40	4%
Të hyra të tjera	374	316	400	-58	-16%
Të hyrat dhe shpenzimet financiare dhe operative	17,823	17,862	19,600	76	0%
Shpenzimet operative (gjithsejtë)	-10,812	-11,088	-11,450	-276	3%
Shpenzimet e personelit	-5,160	-5,202	-5,230	-42	1%
Shpenzimet e tjera operative dhe administrative	-4,548	-4,795	-4,680	-247	5%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-1,104	-1,091	-1,540	13	-1%
Provizionet (gjithsejtë)	-1,591	-1,708	-3,150	-73	4%
Provizionet për kreditë	-816	-1,794	-2,930	-978	120%
Provizionet dhe rezerva e tjera	-819	86	-220	638	-111%
FITIMI PARA TATIMIT	5,376	5,066	5,000	-310	-6%
Shpenzimet e tatimit	-1,018	-543	-500	475	-47%
FITIMI NETO PËR VITIN FINANCIAR	4,358	4,523	4,500	165	4%


Shpenzimet e interesi janë në shumën prej 12,391 mijë euro. Shpenzimet e interesit janë rritur në proporcion të njëjtë me rritjen e depozitave të klientëve.



Të hyrat neto jo nga interesi për vitin 2012 kanë qenë në shumën prej 4,274 mijë euro, dhe kanë qenë në nivelin afërsisht të njëjtë me vitin e kaluar.

Shpenzimet operative (gjithsej) për vitin 2012 ishin në shumën prej 11,088 mijë euro (duke përfshirë shpenzimet e amortizimit) dhe janë rritur për 277 mijë euro krahasim me vitin e kaluar. Arsyeja kryesore për një rritje të tillë është investimet e shumta në renovimin e objekteve të bankës sipas standardeve të NLB d.d.-së, shpenzimet e teknologjisë informative, për të rritur sigurinë e informatave dhe besueshmërinë e sistemeve, etj.

Gjatë vitit, banka ka marrur disa iniciativa për ti racionalizuar shpenzimet dhe kontrolluar ato. Ndërsa koeficienti i shpenzimeve në raport me të hyrat (CIR) ka mbetur në 62.1%



Shënim, detajet e politikave të kontabilitetit në bazë të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur në shpalosjet e pasqyrave financiare.

9. AKTIVITETET SIPAS SEGMENTEVE BIZNESORE

9.1 Korporatat

Aktivitetet e biznesit me personat juridik përfaqësojnë pjesën më të madhe të aktiviteteve të Bankës dhe përbën një pjesë kryesore të rritjes së biznesit. Kjo përfshin kredi afatshkurtër për nevojat aktuale, linja kreditore, mbitërheqje, kredi afatgjatë për financimin e projekteve të investimeve, kredi për ndërtimin e pronave të biznesit, letër kredi dhe garancione, operacione depozitare, shërbimet e transaksioneve të pagesave të brendshme dhe ndërkombëtare.


Duke kombinuar ekspertizën tonë të tregut me njohurinë ndërkombëtare të NLB Grup, ne tashmë kemi krijuar reputacion për konceptin tonë të sofistikuar për subjektet juridike.

Fokusi kryesor dhe strategjia jonë në vitin 2012 ishte në stabilitetin, sigurinë, dhe likuiditetin me qëllim të ndërtimit të një imazhi të një prej bankave më të mira në Kosovë, duke përgatitur baza të forta për rritjen e mëtejshme në vitet e ardhshme.

Banka gjithashtu ka siguruar optimizimin e profilit të rrezikut duke monitoruar së afërmi portofolion kreditore për personat juridik.

Oferta për subjektet juridike është kryer në atë mënyrë duke respektuar modelin e menaxhimit të integruar të marrëdhënieve me klientët, sidomos për klientët e korporatave më të mëdha të Bankës.

Në fushën e operacioneve depozituese, aktivitetet ishin të drejtuara drejt mbledhjes së depozitave të reja nga subjektet juridike, me afate të ndryshme maturimi, kamata të ndryshme dhe destinime të ndryshme. Krahasuar me vitin 2011, depozitat nga subjektet juridike kanë shënuar rritje për 10.9% në vitin 2012 duke arritur shumën prej 124 milionë euro.



Në portfolion kreditore, në fund të vitit 2012, gjithsejt portfolio kreditore e subjekteve juridike është rritur për 17 million euro duke arritur kështu 156 million euro. Banka ka lejuar dy mijë kredi në shumën gjithsejt 130 million euro për subjekte juridike gjatë vitit 2012. Kredite e subjekteve juridike përbëjnë 66% të gjithsejt portfolios kreditore.

Struktura e depozitave të personave juridik:

Personat juridik	2011	2012	Rritja në %
Llogaritë rrjedhëse/avista	36,620	39,770	15
Llogaritë e kursimit	17,689	18,131	2
Llogaritë e kursimit	59,257	65,772	11
Gjithsej	111,566	123,673	11

Tabela në vijim klasifikon sektorët industrial të kredive të kundër-palëve. Në vijim është paraqitur një analizë e kredive dhe klientëve sipas sektorëve industrial me date 31 dhjetor 2012 dhe 2011:

Koncentrimi sipas industrisë

Kreditë neto	31 dhjetor 2012 %	31 dhjetor 2011
Qytetar	27%	22%
Banka	20%	33%
Korporata:		
Industria e ndërtimit	9%	8%
Industria	4%	4%
Shërbimet	9%	10%
Hotelieria	0%	1%
Transporti dhe komunikimi	1%	1%
Tregtia	30%	21%
Gjithsej	100%	100%

9.2. Biznesi retail

Aktivitetet kryesore në Retail kanë qenë të fokusuar në arritjen e standardeve më të larta, bazuar në përvojat dhe rekomadimet e NLB d.d. në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për klientët e bankës, si për persona fizikë, ashtu edhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV). Këto aktivitete janë menaxhuar nga zyra qendrore, në kuadër të sektorëve të ndryshëm por edhe nga rrjeti afarist i bankës. Përkundër kufizimeve ekonomike të tregut, kryesisht mund të themi se në sferën retail, Banka ka arritur të realizojë objektivat kryesore të planifikuara për vitin 2012.

NLB Prishtina është e pranishme në tërë teritorin e Kosovës, në 9 regjionet kryesore, me 51 ekspoziturat dhe sportelet e saja dhe 60 ATM-a të vendosur nëpër të gjitha njësitë e bankës dhe në lokacionet më të frekuentuara. Pothuajë gjysma e këtyre njësive (rreth 50%) janë të renovuara sipas standardeve të NLB d.d., në të cilat ofrohen shërbimet dhe produktet bankare, të fokusuar në nevojat e klientëve, për shërbime të sigurt dhe bashkëkohore. Me qëllim të vlerësimit sa më real të kualitetit të shërbimeve, dhe me qëllim


lim të përmirësimit të tyre të vazhdueshëm, janë organizuar edhe hulumtime lidhur me kënaqësinë e klientëve, nga kompani profesionale. Rezultatet e hulumtimit kanë qenë shumë inkurajuese për Bankën. Me gjithë përpjekjet e bankës për modernizimin e kanaleve bashkëkohore të shpërndarjes (kartela, e-klik, etj.) hulumtimi tregon se ekspozitura, përkatësisht kontakti i klientit me zyrtarin e bankës dhe këshillimi i klientit nga zyrtari i bankës paraqesin kanalin më të rëndësishëm të komunikimit të klientit me bankën.

Gjatë vitit 2012, numri i llogarive rrjedhëse të personave fizikë u rrit në total për 12%, ndërsa numri i llogarive me të hyra të rregullta u rrit për 13.8%. Nga numri i përgjithshëm i klientëve të personave fizikë (rreth 215 mijë) rreth dy të tretat (147 mijë) janë klientë që marrin të hyra të rregullta nëpërmes bankës (paga ose pensione). Edhe pensionistët kanë ndikimin e tyre në rritjen e numrit të klientëve dhe të llogarive. Poashtu llogaritë e të rinjëve dhe studentëve (rreth 5 mijë) paraqesin një potencial për afarizëm me Bankën në të ardhmen.

Afarizmi me kredi individuale - vazhdon të mbetet një nga aktivitetet kryesore të bankës. Portofoli i kredisë për persona fizikë gjatë vitit 2012 është rritur për 13.3%, apo për 9 milion Euro, duke arritur gjithsejt portfolion kreditorë të personave fizikë në shumë prej 78 milion euro. Shumat kryesore të kredive të disbursuara kanë qenë të lidhura me produktet kreditorë të lidhura me banimin e qytetarëve rreth 60 % e kredive dhe të lejuara në afat të kthimit më të gjatë se një vit.

Gjatë tërë vitit, NLB Prishtina ka organizuar fushata të marketingut, me qëllim të përkrahjes së shitjes dhe rritjes së portfolios kreditorë, jo vetëm për persona fizikë por edhe për NVM.

Afarizmi me depozita, poashtu mbetet një nga aktivitetet themelore tradicionale të bankës. Depozitat e personave fizikë gjatë vitit 2012 u rritën me 11%. duke arritur një shume totale prej 243 milion euro, apo një rritje prej 25 milion euro krahasuar me vitin e kaluar. Gjithashtu kualiteti i depozitave ka shënuar një rritje të qëndrueshme. Rreth 75% të depozitave janë të afatizuara..



Edhe te NVM ka pasë një rritje të depozitave rreth 9%, ku pjesa më e madhe e tyre kanë qenë depozita Avista, pra depozitat në llogaritë rrjedhëse, gjë që është normale për natyrën e kësaj kategorie të klientëve.

Struktura e depozitave të personave fizik:

Depozitat e personave fizik	2011	2012	Rritja në %
Llogaritë rrjedhëse/avista	42,620	50,861	19
Llogaritë e kursimit	13,486	19,063	41
Llogaritë e afatizimit	162,373	173,620	7
Gjithsej	218,479	243,544	11

Afarizmi me kartela dhe e-klik - Migrimi i transakcionit, përkatësisht zhvillimi i kanaleve bashkëkohore të distribucionit mbetet një angazhim i vazhdueshëm për bankën. Banka për klientët e vet, ofron brendet më të njohura të kartelave Visa dhe Master. Të gjithë klientët e bankës kanë të drejtë të pajisen me kartela debitore (Visa electron ose Maestro) që njihen ndryshe si kartela bazë. Poashtu janë të dizajnuara edhe produkte të kredit kartelave, shumë të favorshme dhe me interes për klientët, të cilët kanë bonitet të mirë kreditor. Rreth 60,000 klientë persona fizikë janë të pajisur me kartela debitore dhe kreditore. Poashtu edhe rreth 9,500 klientë juridikë - NVM janë të pajisur me kartela debitore.

Numri i ri i klientëve dhe numri i përdoruesve aktivë të bankingut elektronik (e – klik) është në rritje në dy segmentet, por kjo lëmi ka nevojë akoma për kohë, me qëllim të rritjes së vetëdijësimit. Depërtimi i internetit në Kosovë është shumë i lartë, prandaj edhe potenciali për E-klik është i madh në të ardhmen.

Personal Banking - është një shërbim i veçantë dhe ofrohet për klientë të veçantë të bankës dhe shumë kërkuar. Zhvillimi i këtij shërbimi ka qenë një nga prioritetet e bankës në segmentin Retail, me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për klientë të zgjedhur dhe prestigjioz. Oferta e dizajnuar për këtë kategori të klientëve ka bërë që rritja e numrit të klientëve për këtë kategori, gjatë 2012 të jetë rreth 18%.

Përveç produkteve standarde, Banka ofron edhe produkte dhe shërbime të reja si:

- NLB Kursimi Gradual, tërheqja e keshit nga ATM-at e NLB Grupit, për të gjithë klientët e NLB Grupit me tarifa më të volitshme, Visa Revolving credit kartelë, etj.

9.3. Thesari dhe Pagesat**Menaxhimi i Likuiditetit**

Gjatë vitit 2012, Banka në mënyrë të sukseshme ka menaxhuar likuiditetin e bankës në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kërkesat sipas rregulloreve të Bankës Qendrore, Udhëzimeve të Grupit NLB, direktivat e BE-së dhe rregullat e brendshme.

Në periudhën midis 1.1.-31.12.2012, përmbushja mesatare e kërkesës për rezervë minimale të obligueshme të likuiditetit ka arritur në 116,90% të rezervës së përcaktuar duke paraqitur një nivel optimal të përmbushjes.

Në vitin 2012 Qeveria e Kosovës ka filluar lëshimin e bonove të thesarit EUR, duke mundësuar zhvillimin e tregut primar me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të tregut sekondar për letrat me vlerë të qeverisë.

Banka ka marrë pjesë në mënyrë aktive në Tregjet primare në Kosovë dhe Slloveni duke

rritur rezervën e vet sekondare të likuiditetit nëpërmjet blerjes së letrave me vlerë të Kosovës dhe Sllovenisë.

Blerja e bonove të thesarit të Qeverisë së Kosovës në tregun primar është bërë gjithashtu edhe në emër të investitorëve institucionalë.

Gjatë vitit 2012, rregullorja lokale është ndryshuar ku janë paraparë rregulla më të rrepta në likuiditet, ekspozime të mëdha, përqendrimin e depozitave dhe mjaftueshmërinë e kapitalit.

Në mënyrë që të jetë në përputhje me kornizën e re ligjore dhe për të diversifikuar suficitin e fondeve likuide të bankës, banka ka filluar bashkëpunimin me bankat e reja për plasimet në tregun monetar dhe aktivitetet e financimit të tregtisë.

Tregu i këmbimeve të huaja

NLB Prishtina është e vetmja bankë në tregun e Kosovës që ofron shërbime të këmbimit valutor në 9 (nëntë) monedhat likuide - USD, CHF, GBP, NOK, SEK, AUD, CAD, dhe HRK DKK.

Në tregun ndërkombëtar valutor, gjatë vitit 2012 mbi 4.145 transaksione ishin tregtuar për shumën prej 146 bilion euro duke paraqitur një rritje prej 11.32% krahasuar me vitin e kaluar (2011: 135 bilion euro).

Monedhat më të tregtuara gjatë vitit 2012 kanë qenë EUR / USD (rreth 47.57% të të gjitha tregtimeve në numër), pasuar nga EUR / CHF (rreth 43.30% të të gjitha tregtimeve në numër). GBP është i përfshirë në rreth 7.8% të të gjitha tregtimeve Forex. Me qëllim të lehtësimit të procesit të transaksioneve të këmbimit valutor për klientët e bankave, gjatë vitit 2012 banka ka automatizuar miratimin e kursit special të këmbimit për klientët VIP.

Përveç kësaj, për shkak të qasjes së shpejte në platformat tregtare, në vitin 2012 banka ka zvogeluar shpërndarjen e këmbimit valutor dhe i ka ofruar klientëve ofertën më të mirë / kuotim.

Sistemet e pagesave

Gjatë vitit 2012, banka ka mbajtur sisteme efektive të pagesave, duke ju mundësuar klientëve ekzekutim të shpejtë dhe të sigurt të pagesave, në përputhje me standardet e grupit NLB dhe Strategjinë e Bankës Qendrore.

Me qëllim të reduktimit të kostos së klientit mbi pagesat, gjatë vitit 2012 NLB Prishtina ka aplikuar pagesa të shumta të përmirësuara ndërkombëtare me tarifa fikse - për Politikën e sigurimit të pagesave ndërkombëtare, tarifat më të ulëta për pagesat brenda NLB Group.

Banka gjithashtu ka zhvilluar produkte të reja të pagesave për shërbimet e telekom-it, ka avancuar softëra e saj bazuar në Rregulloren e re të BQK-së mbi Pagesat Ndërkombëtare dhe ka implementuar kontrollimin automatik të listave të zeza.

Në fushën e transaksioneve të pagesave ndërkombëtare, në vitin 2012, më shumë se 38 mijë pagesa janë procesuar, si dhe është shënuar një qarkullim prej gjithsej 587 Milion euro. Të hyrat nga jashtë morën pjesë 6.7% në vëllimin total të pagesave ndërkombëtare hyrëse për personat fizik.

Në fushën e transaksioneve të pagesave të brendshme, në vitin 2012, më shumë se

778.000 pagesat janë procesuar, si dhe është shënuar një qarkullim total prej 1.65 bil. Euro, ose 8.8% më shumë se në vitin 2011.

Biznesi dokumentar


Me qëllim të nxitjes së sigurisë dhe parashikueshmërisë në operacionet e garancioneve dhe me qëllim që në mënyrë adekuate të sigurohet një kornizë funksionale për çdo situatë ku kërkesa për garancion është e nevojshme, gjatë vitit 2012 banka ka rishikuar formulimin e Letër garancioneve si per URDG 758 duke risiguruar dhe duke ofruar siguri më të lartë për të dy klientët dhe bankën.

Me qëllim të zvogëlimit të kostos bankare për klientët e bankës, gjatë vitit 2012 banka ka lidhur marrëveshje të reja me bankat korrespondente për arritjen e tarifa të favorshme në fushën e biznesit dokumentar.

Gjatë vitit 2012, Banka ka mbështetur tregtinë e klientëve vendas dhe ndërkombëtar me lëshimin e të gjitha llojeve të leter Garancioneve, Letër Kredive dhe Letër Qëllimet.

Gjithsejtë shuma e garancioneve dhe letër kredive sipas datës 31 dhjetor 2012 ka arritur shumën prej 58,830 milion euro me një rritje prej 11.7 milion Euro krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa me numër është rritur për 1.207.

Garancionet më 31, Dhjetor 2012 sipas llojit



9.4. Teknologjia Informative

Gjatë vitit 2012, në fushën e Teknologjisë Informative (TI) janë implementuar një numër i projekteve infrastrukturore dhe aplikative me qëllim të sigurimit të mbështetjes adekuate të TI-së për proceset afariste dhe iniciativat për zhvillim.

Divizioni i TI-së ka implementuar me sukses zgjidhjen për rimëkëmbje nga katastrofat për shërbimet kritike të virtualizuara e cila shfrytëzon zgjidhjen e avancuar, paraprakisht të implementuar, për rimëkëmbje nga katastrofat. Kjo siguroi rimëkëmbje të shpejtë dhe të besueshme, dhe përmbushjen e qëllimit për kohë sa më të shkurtë të rimëkëmbjes përmes automatizimit të procesit të aktivizimit të shërbimeve në lokacionin rezervë dhe testimin e rregullt të planeve të rimëkëmbjes.

Me qëllim të sigurimit të rimëkëmbjes efikase në rast të katastrofave, Divizioni i TI-së vazhdoi me rishikimin e Planit për Vazhdimësinë e Punës (PVP) përmes rishikimit të dokument-

eve dhe kryerjes së testeve kuartale sipas planit të përcaktuar paraprakisht në fillim të vitit kalendarik

Në fushën e infrastrukturës, Divizioni i TI-së vazhdoi me procesin e standardizimit dhe modernizimit të pajisjeve të rrjetës duke arritur synimin që të operojë me pajisje të vetëm një prodhuesi dhe të kualitetit më të lartë. Duke kuptuar se Voice over IP (VOIP) është duke u bërë teknologji e preferuar e komunikimit, Divizioni i TI-së ka implementuar një zgjidhje më të avancuar në treg. Mundësia e funksionimit konvergjent të VOIP, që i bashkon të dhënat dhe zërin në një gjë të vetme, që operon duke shfrytëzuar të njëjtën infrastrukturë, ka ndihmuar në uljen e shpenzimeve dhe rritjen e fleksibilitetit. Procesi i vazhdueshëm i përmirësimit të infrastrukturës vijoi me sigurimin e lidhjes optike të degëve, si për lidhjen primare ashtu edhe për atë sekondare, së bashku me instalimin e magjistrales optike në selinë e re të bankës.

Përpjekje dhe kohë të konsiderueshme janë shpenzuar për t'u siguruar se infrastruktura e TI-së në ndërtesën e re afariste është ndërtuar sipas standardeve më të mira me qëllim të ndërtimit të një qendre të besueshme e të dhënave, duke përfituar maksimalisht nga investimi i bërë.

Duke kuptuar nevojën për punë në pajtueshmëri me aktet rregullative, bashkërendimin mes pjesës afariste dhe TI-së, kthimin më të mirë në investime në TI, menaxhimin më të mirë të sigurisë, privatësisë dhe riskut, dhe implementimin më të suksesshëm të projekteve, Divizioni i TI-së gjatë vitit 2012 ishte i përkushtuar në përvetësimin e standardeve që burojnë nga COBIT korniza si kornizë e preferuar e menaxhimit të TI-së.

10. MENAXHIMI I RISKUT

10.1. Risku kreditor, Risku i likuiditetit, Risku i normës kamatore, Risku operacional

Në drejtim të tregut të Kosovës dhe trendeve globale të industrisë financiare, Sektori i Riskut i NLB Prishtina ka një rol kyç në operacionet bankare duke mbështetur qasjen konzervative të menaxhimit të risqeve. Aktivitetet e ngjajshme të menaxhimit të riskut janë zgjeruar nga përfshirja e mëtejshme e Departamentit në procesin e vendimmarrjes strategjike, gjithashtu duke shtuar vlerë dhe vetëdijësimin mbi riskun në fusha të tilla si çmimi, zhvillimi i produktit. Kështu, roli kryesor i departamentit të menaxhimit të rrezikut është reflektimi dhe zbatimi i apetitit të rrezikut të grupit NLB, në drejtim të specifikave të tregut vendor, me një objektiv të vetëm të ruajtjes dhe kontributit në menaxhimin e cilësisë efektive dhe efikase të aseteve.

Risku kreditor

Risku kreditor përfshin menaxhimin e vazhdueshëm të portofolios përmes monitorimit dhe analizave të performancës së portofolios dhe koncentrimit. Kështu, ky proces përfshin monitorimin dhe analizimin e investimeve individuale, performancën financiare të klientëve në mënyrë që të sigurojë nivelin e duhur të cilësisë së aseteve.

Në 12 muajt e fundit NLB Prishtina ka ruajtur trendin e rritjes me diversifikim të arsyeshëm të portofolios me kredi dhe avanse për bankat, jo-bankat dhe ekspozimet jashtë bilancore. Rritja e portofolios ka qenë e përcjellur nga rritja e profitabilitetit, si dhe me një rritje të cilësisë së aseteve. Rritja vjetore e investimeve në SJB ishte 12.4%. Ndërsa, si pasojë janë zvogëluar investimet në drejtim të sektorit bankar. Duke pasur parasysh vetëdijësimin e NLB Prishtina mbi riskun, avancet e saj ndaj bankave janë fokusuar kryesisht në bankat ndërkombëtare me vlerësim të lartë ndërkombëtar kreditor.

Pjesëmarrja e klasifikimit kreditor A dhe B në portofolion e përgjithshme është 91% më 31 dhjetor 2012 (89.1% në 31 dhjetor 2011), për investime në sektorin jobankar, i cili tregon një trend të shëndoshë dhe të qëndrueshme për performancën dhe cilësinë e portofolios. Ndërsa, mbulesa me provizione për kategoritë e mbetura të portofolios (C, D dhe E) është 127% më 31 Dhjetor 2012 (140% më 31 Dhjetor 2011).

Risku i likuiditetit

NLB Prishtina ka përpiluar Politikën mbi menaxhimin e Riskut të Likuiditetit, e cila përcakton limitet, masat dhe monitorimin e menaxhimit të riskut të likuiditetit. Prandaj gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2012, Departamenti i Menaxhimit të Riskut ka monitoruar dhe raportuar mbi likuiditetin strukturor dhe likuiditetin operacional, duke përfshirë limitet rregullative të caktuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Kështu, gjatë vitit NLB Prishtina për shkak të pozicionit të saj të mirëfilltë të likuiditetit ishte në gjendje të përmbush të gjitha limitet e përcaktuara

Risku valutor

Risku valutor përfaqëson probabilitetin e realizimit të humbjeve për zërat bilancor dhe jashtë-bilancor, si rezultat i ndryshimeve në normat valutore dhe/ose mos-harmonizimi në nivelin e aseteve, detyrimeve dhe zerave jashtë bilancor në valutë të njejtë. Shumica e transakcioneve në valutë të huaj të kryera nga NLB Prishtina janë në dollar amerikan, franga zvicerane dhe në paund britanikë. Duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e mundshme të këmbimeve të huaja valutore, departamenti I Riskut përcjell pozicionet e hapura valutore në baza ditore. Një monitorim i afërt i pozicionit, i ka mundësuar NLB Prishtina një menaxhim efikas dhe efektiv të pozicioneve të hapura duke i përmbushur limitet e caktuara me Politikën e Menaxhimit të Riskut Valutor

Pozicioni bruto i hapur valuator i bankës me 31 Dhjetor, 2012 sipas politikave të NLB grupës duhet të jetë brenda kornizës së 3% të ekuitetit, pozicioni individual valuator i hapur, sipas kërkesave të BQK-së për secilën valutë duhet të mos jetë më shumë se 30% e kapitalit.

Risku i Normës Kamatore

Qëllimi i menaxhimit të riskut është ekspozimi ndaj riskut të normës kamatore dhe kufizimin e humbjeve të mundshme, e cila është krijuar si rezultat i modifikimit të niveleve të normave të interesit në treg dhe efektin e këtyre ndryshimeve mbi rezultatet e biznesit dhe vlerës së tregut të kapitalit të bankës. Departamenti I Menaxhimit të Riskut bën monitorimin mujor të ekspozimeve të bankës ndaj normave kamatore, përmes monitorimit të limiteve, në mënyrë që të sigurojë pajtueshmëri të plotë me afatet e përcaktuara nga politikat e menaxhimit të riskut të normës së interesit.

Risku operacional

Qëllimi i menaxhimit të rrezikut është të menaxhojë ekspozimin ndaj rrezikut operacional dhe zvogëloj humbjet potenciale që mund të ndodhin për shkak të sistemeve të papërshtatshme të brendshme, procesin e kontrollit, dobësitë dhe dështimet gjatë procesit të punës, aktiviteteve ilegale dhe ngjarjeve të jashtme të cilat mund t'i shkaktojnë humbje bankës.

Prandaj, në mënyrë që të mundësohet një sistem i shëndoshë i menaxhimit të rrezikut, NLB Prishtina ka krijuar strukturat e duhura (komiteti për menaxhimin e riskut operacional) dhe ka caktuar përgjegjësitë në strukturën organizative të bankës, në mënyrë për të siguruar identifikimin efikas të rrezikut, regjistrimin, zbutjen dhe monitorimin e rrezikut operacional. Në të njëjtën kohë, ngjarjet e dëmshme që rrjedhin nga rreziku operacional janë monitoruar në mënyrë aktive në baza mujore dhe janë raportuar te organet e brendshme të NLB Prishtina.

Më shumë detaje, rreth menaxhimit të riskut janë të detajuara në shënimet e pasqyrave financiare në këtë raport.

10.2. Menaxhimi i riskut të adekuatshmërisë së kapitalit

Gjatë vitit përfunduar me 31 dhjetor 2012 është lëshuar Rregullorja e re e Bankës Qendrore për adekuatshmërinë e kapitalit, në përputhje me ligjin e ri mbi bankat. Sidoqoftë, pavarësisht nga prezantimi i rregulloreve të reja, NLB Prishtina ka qëndruar mbi minimumin e limiteve të caktuara të adekuatshmërisë së kapitalit, duke mbajtur një nivel mbi 12%. Në ndërkohë, për shkak të qasjes konzervative drejt menaxhimit të adekuatshmërisë së

kapitalit, NLB Prishtina ka vazhduar me politiken e vet të kapitalizimit gjatë vitit 2012, duke mos iu deklaruar dividendën aksionarëve, në pajtueshmëri me vendimin e Mbledhjes së përgjithshme të Aksionarëve.

Më 31 dhjetor 2012, kapitali ishte në shumën prej 39.198 mijë euro (Tier I dhe II). Totali i mjeteve të rrezikuara në fund të vitit ishte 289.395 mijë euro, dhe adekuatshmëria e kapitalit si më 31 dhjetor 2012 ishte 13.5%.

Detajet e adekuatshmërisë së kapitalit bazuar në BQK

Kategoria	31.12.10	31.12.11	31.12.12 *
I. Kapitali (Tier 1)	32,538	36,956	36,682
1. Kapitali themelor	20,498	20,498	20,498
2. Rezervat (fitimi i akumuluar)	8,008	12,030	16,464
3. Suficiti i rivlerësimit	10	-6	241
4. Fitimi i vitit aktual	4,022	4,434	4,502
5. Mjetet e paprekshme*	0	0	-596
6. Kredite e palëve të lidhura me bankën *	0	0	-4,427
II. Kapitali plotësues (Tier 2)	1,973	2,167	2,516
Provizionet e përgjithshme (1.25%) për kredite e kategorisë A,B	1,973	2,167	2,516
Kapitali (Tier 1 + Tier 2)	34,511	39,123	39,198
Gjithsejt mjetet e rrezikuara	211,816	237,750	289,395
Zërat në bilancë	190,491	211,721	237,487
Zërat jashtbilancor	21,325	26,029	29,685
Mjetet e rrezikuara nga risku operacional *	0	0	22,223
Koeficienti i adekuatshmërisë së Kapitalit	16.3%	16.5%	13.5%

11. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Trendet e zhvillimit të cilat po i karakterizojnë ditët e sotme, pa dyshim tregojnë se shoqëria do të mbështetet në vlera të reja, në thelb të cilave janë vlerat jo-materiale, përkatësisht dituria, informatat, idetë komunikimi dhe inteligjenca e resurseve njerëzore.

Pjesë e këtyre trendeve për vitin 2012 ishte edhe Banka e cila kishte qëllimin e caktuar. Faktor themelorë për realizimin e qëllimit të Bankës gjithsesi ishte njeriu si aset më i çmuar i Bankës dhe puna e tij.

Dihet se nevoja për njohuri të njeriu është e vazhdueshme. Këto njohuri, njeriu mund të fitojë përmes të mësuarit që fillon nga moshë e re dhe vazhdon t'i plotësoi deri në moshën e pjekur. Edhe pse aktualisht mënyrat e edukimit janë edukim formal dhe edukim joformal, në rastin tonë konkret kemi të bëjmë me edukim joformal. Në këtë drejtim, Banka vitin e kaluar ka bërë përpjekje për rinovimin e njohurive të të punësuarve të saj nëpërmjet plotësimit të njohurive përmes seminareve me ushtrime nga përvoja (NLB d.d.), sesioneve të punës për tema të zgjedhura, trajnimeve brenda dhe jashtë Bankës (BQK, SHBK, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë etj), studimit të rasteve dhe ligjëratave të lidhur me tema të veçanta.

E veçantë e vitit që lamë pas ishte se për herë të parë Banka në bashkëpunim me NLB d.d., këta të fundit me një institucion në Lubjanë, ka filluar mësimin e gjuhës angleze me disa të punësuar me programin EF ONLINE LANGUAGE LEARNING për një periudhë prej 365 ditë, është bërë segmentimi i grupeve të caktuar të punësuarve të cilët në krahasim me pjesën tjetër kanë mundësi më të lartë për zhvillim profesional dhe për të arritur efektivitet më të madh, njëkohësisht janë kandidat potencial për të zënë vende kyçe në Bankë si dhe kompania slovene DIALOGOS nga Lubjana në dhjetor të vitit 2012 ka bërë anketë me të gjithë të punësuarit me temën "Hulumtimi i pikëpamjeve, mendimeve dhe kënaqësive tek të punësuarit në NLB Prishtina. Rezultati i përgjithshëm është se ajo tregon se atmosfera në punë është pozitive dhe pothuajse të gjithë treguesit tregojnë rezultateve mbi nivelin e mesatares në kuadër të NLB Group.

12.PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT

NLB PRISHTNA SH.A.

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)**

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor, 2012

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR	3-4
PASQYRA E POZITES FINANCIARE	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	7
PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE	
SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	9 - 84



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të NLB Prishtina Sh. a.

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të NLB Prishtina Sh. a të cilat përmbajnë pasqyrën e gjendjes financiar më 31 Dhjetor 2012, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontroleve të brendshme të nevojshme për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit; përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e vlerësimeve të arsyeshme kontabël në rrethanat përkatëse.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfutur siguri të arsyeshme për mungesën e gabimeve materiale në pasqyrat financiare.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e evidencave të auditimit që mbështesin shumat dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak mashtrimesh apo gabimesh. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të përcaktuar procedurat e auditimit që i përshtaten rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të njësisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të mbështetur opinionin tonë.

PricewaterhouseCoopers Kosovo, Rr. Mujo Ulqinaku, Nr. 5, Ap. 4, Qyteza Pejton, 10 000, Prishtina, Kosova
T: +381 (0) 38722 555/+377 (0) 45322 722, F: +381 (0) 38722 276, www.pwc.com/ks

Regjistruar në Anëncinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë me Nr të Regjistrimit 70609711



Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat përcjellëse financiare japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të NLB Prishtina Sh.a më 31 Dhjetor 2012 si dhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

PricewaterhouseCoopers Kosovo

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k

Prishtinë,

26 Shkurt 2013

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor, 2012

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

	Shënim	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
ASETET			
Paraja e gatshme dhe gjendja me bankat	4	18,949	20,327
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	5	51,456	21,872
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	6	48,720	92,171
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	7	234,138	208,298
Pasuritë financiare të disponueshme për shitje	9	58,383	35,615
Pasuritë tjera financiare		11	-
Pasuritë tjera	10	594	340
Parapagimi i tatimit mbi te ardhurat	25	191	-
Pasuritë, prona dhe impiantet	11	10,281	7,035
Pasuritë afatgjata jo materiale	12	596	566
Tatimi i shtyrë	25	157	235
Gjithsejt asetet		423,476	386,459
DETYRIMET			
Detyrimet ndaj bankave	13	209	379
Detyrimet ndaj klientëve	14	367,217	330,045
Detyrimet tjera financiare	15	3,557	3,784
Detyrimet tjera	16	745	1,320
Detyrimet e tanishme të tatimit	25	-	95
Huamarrjet	17	8,774	12,632
Gjithsejt detyrimet		380,502	348,255
KAPITALI I AKSIONAR			
Kapitali aksionar	18	20,498	20,498
Rezerva e ri-vlerësuar për letrat me vlerë	9	241	(6)
Fitimi i pashpërndarë		22,235	17,712
Gjithsejt kapitali		42,974	38,204
Gjithsejt detyrimet dhe kapitali aksionar		423,476	386,459

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Udhëheqës më 15 shkurt, 2013 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

Z. Albert Lumezi
 Kryetar i bordit menaxhues

Z. Bilall Hoti
 Drejtor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE****Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor, 2012****(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)**

	Shënim	Viti i përfunduar31 Dhjetor, 2012	Viti i përfunduar31 Dhjetor, 2011
Të hyrat nga interesi	19	26,533	25,045
Shpenzimet e interesit	20	(12,391)	(11,037)
Të hyrat neto nga interesi		14,142	14,008
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	21	4,374	4,371
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	22	(970)	(931)
Neto të hyrat nga provizionet dhe komisionet		3,404	3,440
Neto fitimi nga këmbimet në valuta të huaja		369	349
Të hyrat tjera operative		(53)	25
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	7	(1,794)	(815)
Humbjet dhe provizionet tjera për zhvlerësim	8	86	(1,004)
Shpenzimet e personelit	23	(5,202)	(5,159)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit		(1,091)	(1,105)
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	24	(4,795)	(4,549)
Fitimi para tatimit		5,066	5,190
Tatimi në fitim	25	(543)	(833)
Neto fitimi për vitin		4,523	4,357
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse (humbja):			
Neto (humbjet) fitimi nga ndryshimi i vlerës reale të AFS letrave me vlerë	26	247	(16)
Gjithsejt të hyrat gjithpërfshirëse për vitin		4,770	4,341

Shënimet shpjeguese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor, 2012

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

	Kapitali aksionar	Rivlerësimi i rezervës për AFS letrat me vlerë	Fitimi i pashpërndarë	Gjithsejt
Gjendja me datë 1 Janar, 2011	20,498	10	13,355	33,863
Neto fitimi për vitin	-	-	4,357	4,357
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse / (humbja)	-	(16)	-	(16)
Gjithsejt të hyrat gjithpërfshirëse/(humbja)	-	(16)	4,357	4,341
Gjendja me datë 31 Dhjetor, 2011	20,498	(6)	17,712	38,204
Neto fitimi për vitin	-	-	4,523	4,523
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse / (humbja)	-	247	-	247
Gjithsejt të hyrat gjithpërfshirëse/(humbja)	-	247	4,523	4,770
Gjendja me date 31 Dhjetor, 2012	20,498	241	22,235	42,974

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.**PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2012

(Të gjitha vlerat janë në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

		Për vitin që perfundon më 31 Dhjetor, 2012	Për vitin që perfundon më 31 Dhjetor, 2011
	Shenime		
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi gjatë vitit para tatimit		5,066	5,190
Zhvlerësimi	11	914	935
Amortizimi	12	177	170
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	7	1,794	1,068
Shlyerja e pasurive afatgjata materiale		25	30
Të hyrat nga interesi		(26,533)	(25,045)
Shpenzimet e interesit		12,391	11,037
		(6,166)	(6,615)
Rritja/ Zvogëlimi në balancë me BQK		(3,278)	11,450
Zvogëlimi në Kkreditë dhe paradhëniet për bankat		(3,636)	5,869
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për klientët		(27,843)	(23,452)
Rritja/ Zvogëlimi në detyrimet ndaj bankave tjera		(11)	-
Rritja/ Zvogëlimi në detyrimet tjera		(303)	398
Rritja/ Zvogëlimi në detyrimet ndaj bankave tjera		170	(308)
Rritja/ në llogaritë rrjedhëse		36,711	33,093
Rritja/ Zvogëlimi në detyrimet tjera financiare		(226)	1,336
Zvogëlim/Rritja në detyrimet e tjera		(574)	95
		5,156	21,866
Interesi i arkëtuar		26,440	25,118
Interesi i paguar		(11,925)	(10,332)
Tatimi i paguar në të ardhura	25	(777)	(514)
Rritja e parasë nga aktivitetet operative		8,582	36,138
Qarkullimi i nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurive dhe pajisjeve		(4,185)	(2,613)
Blerjet e aseteve të paprekshme		(208)	(171)
Blerja e bonove jo-kapitale		(22,768)	(14,117)
		(27,161)	(16,901)
Neto para e gatshme e përdorur në aktivitetet Investuese			
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet financiare			
Pagesa e huazimeve		(3,853)	(4,201)
Hyrja e parave nga aktivitetet financiare		(3,853)	(4,201)
Rritja e parave të gatshme dhe barasvlerave të parave		(22,432)	15,036
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e tyre më 1 Janar		122,308	107,272
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31 Dhjetor		99,876	122,308

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

NLB Prishtina Sh.a. është bankë komerciale ("Banka ") e regjistruar ne Regjistrinë e Kosovës nën Certifikatën e Regjistrimit nr. 70053484 të datës 18 Dhjetor, 2007. Banka është krijuar nga bashkimi i dy bankave, Kasabank dhe Banka e re e Kosovës (gjatë vitit 2007 të dy bankat ishin nën kontroll Në e Nova Ljubljanska Banka d.d.), dhe ka fituar licencën për aktivitete bankare më 19 Dhjetor, 2008 nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK").

Banka kontrollohet nga Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana me qendër në Slloveni (Banka amë), e cila posedon 81.21% të aksioneve sipas datës 31 Dhjetor 2012 (31 Dhjetor 2012: 81.21% të aksioneve). Aksionarët më të mëdhenj të Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana janë Republika e Sllovenisë që posedon 45.62% të aksioneve dhe KBC Bank N.V. Brussels (Në tekst Në vijim: KBC), që posedon 22.04% të aksioneve.

Qendra e regjistruar e Bankës gjendet në Rr. Rexhep Luci Nr. 5, Prishtinë, Kosovë. Banka vepron si bankë komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj me 10 degë në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Besianë, Prizren, dhe 52 Nën-degë Pasqyrat financiare për Bankën për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012 janë aprovuar nga Bordi Udhëheqës më 15 Shkurt 2013.

Vërejtje: Këto pasqyra janë perkthim i verzionit anglisht të pasqyrave financiare të audituara, dhe në rast se ka ndonjë mosbarazim, jo harmonizim apo keqinterpretim në mes të dy llojeve, atëherë do të mbizoteron verzioni Anglisht i pasqyrave IFRS.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË NDRYSHUARA NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

2.1. Standardet dhe Interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Ndryshimet në vijim të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi për Standardet Ndërkombëtare Kontabël (SNK) dhe interpretimet e lëshuara nga Komiteti për Interpretimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (KISNRF) ka qenë në fuqi nga 1 Janari ,2012:

- **Shpalosje —Transferimi i pasurive financiare – Ndryshimet në SNRF 7 (publikuar në 2010 dhe efektiv për periudhat vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Korrikut, 2011).** Ndryshimi kërkon informata shtesë në lidhje me rrezikun e ekspozimit që vjen nga pasuritë e transferuara financiare. Ndryshimi përfshinë një kusht të informimit për pasuritë sipas klasës dhe natyrës, shumën dhe një përshkrim të rrezikut dhe shpërblimit të pasurive financiare të cilat janë transferuar tek pala tjetër, mirëpo akoma figurojnë në bilancin e gjendjes së entitetit. Informatat poashtu kërkojnë për të mundësuar përdoruesin të kuptojë shumën e çfarëdo obligimi përcjellës, si dhe marrëdhënien në mes të pasurive financiare dhe detyrimeve përcjellëse. Aty ku pasuritë financiare janë ç’regjistruar, mirëpo entiteti akoma i ekspozohet rreziqeve dhe shpërblimeve të caktuara që shoqërojnë pasuritë e transferuara, dhe kërkohej informim të mëtutjeshëm për të mundësuar të kuptuarit e efekteve të atyre rreziqeve. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **Hiper-inflacioni i ashpër dhe heqja e ditëve të fiksuara për adaptuesit e parë – Ndryshimet në SNRF 1 (publikuar në Dhjetor 2010 dhe në fuqi për periudhat vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Korrikut, 2011).** Ndryshimi lidhur me hiper-inflacionin e ashpër krijon një përjashtim shtesë kur një entitet, i cili i është nënshtruar hiper-inflacionit, vazhdon të prezantojë – apo prezanton për herë të parë – pasqyra financiare në pajtim me SNRF-të. Përjashtimi lejon një entitet të zgjedh për të matur pasuritë dhe detyrimet të caktuara me vlerën fer, dhe ta përdorë atë vlerë si kosto të vlerësuar në hapjen e pasqyrës të SNRF të pozitës financiare. Bordi i SNK poashtu ka ndryshuar SNRF 1 për të eliminuar referimet në data fikse për një përjashtim dhe një lirim, të dyja që kanë të bëjnë me pasuritë dhe detyrimet financiare. Ndryshimi i parë kërkon adoptuesit – që e bëjnë për herë të parë – të zbatojnë kërkesat e mosnjohjes të SNRF-ve në mënyrë prospektive nga data e tranzicionit, e jo nga 1 Janari, 2004. Amandamentimi i dytë ka të bëjë me pasuritë apo detyrimet financiare ku vlera fer është e përcaktuar përmes teknikave vlerësuese në njohjen fillestare, dhe lejon që udhëzimi të zbatohet në mënyrë prospektive nga data e kalimit në SNRF, sesa nga 25 tetori 2002 ose 1 Janar 2004. Kjo d.m.th. që adoptuesit – ata që e bëjnë për herë të parë – nuk kanë nevojë të përcaktojnë vlerën fer të pasurive dhe detyrimeve të caktuara në njohjen fillestare për periudhat para datës së tranzicionit. SNRF 9 poashtu është amandamentuar për të reflektuar këto ndryshime. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **Mbulimi i pasurive themelore – Ndryshimet në SNK 12 (Publikuar në Dhjetor 2010 dhe në fuqi për periudhat vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2012).** Amandamenti ka plasuar një prezumim demantues se prona e investuar e zbatuar me vlerën fer kthehet krejtësisht përmes shitjes. Ky prezumim është përgenjështuar nëse prona e investimit mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është qenësish të konsumojë të gjitha përfitimet ekonomike të mishëruara në pronën e investimit përgjatë kohës, se sa përmes shitjes. SIC-21, tatimi në të hyrat – rikthimi i pasurive jo-zhvlerësuese të rivlerësuar, i cili adreson çështjet të ngjashme përshtirë pasuritë jo-zhvlerësuese të matura, duke përdorur modelin e rivlerësimit në SNK 16, prona, ndërtesa dhe pajisjet ishin inkorporuar në SNK 12 pas përjashtimit nga fushëveprimi i saj i pronave të matura investuese me vlerë fer. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.

Adoptimi i këtyre amandamenteve të interpretimeve të standardeve ekzistuese nuk ka shpër në ndonjë ndryshim domethënës në politikat kontabël të bankës.

**2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË NDRYSHUARA
NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)**

2.2 Standardet dhe interpretimet të cilat akoma nuk janë në fuqi (efektive nga 1 janari 2013 apo më vonë)

Në ditën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, ndryshimet dhe interpretimet në vijim ishin në publikim mirëpo akoma jo në fuqi:

SNRF 9, “Instrumentet financiare: klasifikimi dhe matja”. Ky standard, i publikuar në nëntor të vitit 2009, zëvendëson ato pjesë të SNK 39 që lidhen me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. SNRF 9 u ndryshua më tej në Tetor 2010 për të përcaktuar klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare dhe në Dhjetor 2011 (i) për të ndryshuar datën efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2015 dhe (ii) për të përfshirë shënime shpjeguese për periudhën kalimtare. Karakteristikat kryesore të standardit janë si më poshtë:

- Pasuritë financiare duhet të klasifikohen në dy kategori matje: në pasuritë financiare të cilat do të maten në periudhat e mëpasshme me vlerë fer, dhe ato të cilat do të maten në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuar. Vendimi duhet të merret në momentin e njohjes fillestare të pasurisë. Klasifikimi varet nga modeli që njësia ekonomike ndjek për menaxhimin e aktiveve të veta financiare dhe karakteristikat e flukseve monetare të instrumentit.
- Një instrument matet në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuar vetëm nëse është një instrument borxhi dhe dy kushtet në vijim plotësohen njëkohësisht: (i) objektivi i njësisë ekonomike është të mbajë aktivin për të mbledhur/përfitur flukset monetare kontraktuale, dhe (ii) flukset monetare kontraktuale të pasurisë përfaqësojnë vetëm pagesa principali dhe interesi (që do të thotë që instrumenti ka vetëm “karakteristikat bazë të huasë”). Të gjithë instrumentet e tjerë të borxhit duhet të maten me vlerë fer nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- Të gjithë instrumentet e kapitalit duhet të vlerësohen në periudhat e mëpasshme me vlerë fer. Instrumentet e kapitalit të cilat mbahen për tregtim do të maten me vlerë fer nëpërmjet fitimit ose humbjes. Ndërkohë, për gjithë instrumentet e tjerë të kapitalit, në momentin e njohjes fillestare mund të bëhet një zgjedhje e pakthyeshme për të njohur fitimet dhe humbjet kapitale të realizuara dhe të perealizuara përmes të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse dhe jo përmes fitimit ose humbjes. Fitimet ose humbjet nga vlera fer nuk do të kalojnë më përmes fitimit ose humbjes. Kjo zgjedhje mund të bëhet veçmas për çdo instrument. Dividendët duhet të prezantohen në fitim ose humbje, për sa kohë që përfaqësojnë kthime nga investimi.
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë transferuar pa ndryshime tek SNRF 9. Ndryshimi kryesor është se njësia ekonomike tashmë i kërkohet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë fer përmes fitimit ose humbjes në të hyrat të tjera gjithëpërfshirëse.

Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË NDRYSHUARA NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

2.2. Standardet dhe interpretimet të cilat akoma nuk janë në fuqi (vazhdim)

- **SNRF 10, Pasqyrat financiare të konsoliduara (publikuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2013)**, zëvendëson të gjitha udhëzimet mbi kontrollin dhe konsolidimin në SNK 27 “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të ndara”, dhe SIC – 12 “Konsolidimi – entitetet me qëllime të veçanta”. SNRF 10 ndryshon definicionin e kontrollit në mënyrë që kriteret e njëjta të aplikohen për të gjitha entitetet për të përcaktuar kontrollin. Ky standard çon më tutje parimet ekzistuese duke identifikuar konceptin e kontrollit si faktor përcaktues se a duhet një entitet të përfshihet në pasqyrat e konsoliduara financiare. Standardi ofron udhëzime shitesë për të ndihmuar në përcaktimin e kontrollit aty ku kjo është vështirë të vlerësohet. Ky standard i ri mund të ndikojë në entitetet të cilat një grup i konsolidon si filiale të tij. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **SNRF 11, Marrëveshjet e përbashkëta, (publikuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2013)**, zëvendëson SNK 31 “interesat në sipërmarrje të përbashkëta” dhe SIC-13 “Entitetet e kontrolluara bashkërisht - kontributet-jo-monetare nga sipërmarrjet”. Ndryshimet në definicione kanë reduktuar numrin e llojeve të aranzhimeve të përbashkëta në dy: operacionet e përbashkëta dhe sipërmarrjet e përbashkëta. Politikat ekzistuese për zgjedhjen e konsolidimit proporcional për entitetet e kontrolluara bashkërisht janë eliminuar. Ky standard ofron një pasqyrim më realist të aranzhimeve të përbashkëta, duke u fokusuar në të drejtat dhe detyrimet e aranzhimeve, më shumë se sa në formën e saj ligjore. Janë dy lloje të aranzhimeve të përbashkëta: Operacionet e përbashkëta dhe sipërmarrjet e përbashkëta. Të parat dalin aty ku një operator i përbashkët ka të drejta në pasuritë dhe detyrimet që burojnë nga aranzhimet, andaj kemi llogaritë për interesin e tij në pasuritë, detyrimet, të hyrat dhe shpenzime. Sipërmarrjet e përbashkëta shfaqen kur operatori i përbashkët ka të drejta në neto pasuritë e aranzhimeve dhe rrjedhimisht kemi llogaritë e ekuitetit për interesin e tij. Konsolidimi proporcional i sipërmarrjeve të përbashkëta nuk lejohet më. Ekuiteti kontabël është obligativ për pjesëmarrje në sipërmarrjet e përbashkëta. Nuk pritët që të ketë ndonjë efekt në pasqyrat financiare të Bankës. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **SNRF 12, Shpalosjet e interesit në entitetet tjera, (publikuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2013)**, vlen për entitete të cilat kanë një interes në një filial, në një aranzhim të përbashkëta, në një entitet bashkëpunues apo me strukturë të pakonsoliduar. Zëvendëson kushtin e informatave në SNK 28 “Investimet në bashkëpunëtorë”. SNRF 12 kërkon nga entitetet të zbulojnë informata, të cilat u ndihmojnë lexuesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën, rrezikun dhe efektet financiare të cilat shoqërojnë interesat e entitetit në filiale, bashkëpunëtorë, aranzhime të përbashkëta dhe entitete të pakonsoliduara. Për t’i përmbushur këto objektiva, standardi i ri kërkon zbulim informatash në disa fusha, përfshirë edhe gjykimet dhe supozimet në përcaktimin nëse entiteti kontrollon, bashkërisht apo ndikon në masë domethënëse interesat e saj në entitetet tjera, pastaj informata të gjera për hisen e interesave jo-kontrolluese në aktivitetet e grupit dhe rrjedha të parasë, informata të përmbledhura financiare të filialeve me interesa material jo-kontrolluese, dhe zbulime të detajuara të interesave në entitetet të pakonsoliduara. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË NDRYSHUARA NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

2.2. Standardet dhe interpretimet e publikuara akoma jo në fuqi (vazhdim)

- **SNFR 13, “Matja e vlerës fer”** (publikuar në Maj të vitit 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar, 2013), ka për qëllim të përmirësojë konsistencën dhe të reduktojë kompleksitetin duke ofruar një përkufizim të rishikuar të vlerës fer, një burim të vetëm për matjen e vlerës fer
- , si dhe kërkesat për dhënien e shënimeve shpjeguese për përdorim nga gjithë SNRF-të. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **SNK 27, Pasqyrat e ndara financiare, (ndryshuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 janarit 2013)**, është ndryshuar dhe objektivi i saj është të përshkruajë kushtet kontabël dhe të zbulimit të informatave për investime në filiale, sipërmarrje të përbashkëta, bashkëpunuese kur entiteti përgatitë pasqyrat financiare. Udhëzimi për kontrollin dhe pasqyrat e konsoliduara financiare është zëvendësuar me SNRF 10, “Pasqyrat e Konsoliduara Financiare”. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **SNK 28, Investimet në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkëta, (ndryshuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2013)**. Ndryshimi i SNK 28 ka dalë nga projekti i Bordit mbi sipërmarrjet e përbashkëta. Kur projekti u diskutua, Bordi vendosi të inkorporoj kontabilitetin për sipërmarrje të përbashkëta duke përdorur metodën e ekuitetit në SNK 28 ngase kjo metodë është e zbatueshme si për sipërmarrje të përbashkëta ashtu dhe për bashkëpunëtorë. Me këtë përjashtim, udhëzimi tjetër ngel i pandryshuar. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **Ndryshimet në SNK 1, “Paraqitja e pasqyrave financiare”** (publikuar në Qershor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik, 2012) ndryshojnë mënyrën e paraqitjes së shënimeve shpjeguese të zërave të përfshira në të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet kërkojnë që njësia ekonomike të paraqesë zërat e paraqitur në të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse në dy grupe, në varësi të faktit nëse ekziston mundësia e ri-klasifikimit të tyre në fitim ose humbje në të ardhmen. Emërtimi i sugjeruar nga SNK 1 është ndryshuar në “pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse”. Banka aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardeve të amandamentuara në pasqyrat e saj financiare.

SNK 19 e ndryshuar, “Përfitimet e punonjësit” (publikuar në Qershor 2011, dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2013), bën ndryshime domethënëse në njohjen dhe matjen e përfitimit të definuar të shpenzimit pensional dhe përfitimet e shkarkimit, dhe në dhënien e informatave për të gjitha përfitimet e punonjësit. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në obligimin neto të definuar përfitues (pasuri) atëherë kur ndodhin, si në vijim: (i) kostoja e shërbimit dhe neto interesi në fitim apo humbje; dhe (ii) rimatjet në të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse. Nuk pritet që të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të bankës.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT TË REJA DHE TË NDRYSHUARA (VAZHDIM)

2.2. Standardet dhe interpretimet të publikuara por që ende nuk janë në fuqi (vazhdim)

- **IFRIC 20, Kostot e blerjes në fazën e prodhimit të një minierë sipërfaqësore, (publikuar në Tetor 2011 dhe efektive për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2013).** Interpretimi sqaron se përfitimet nga aktivitetet blerëse merren parasysh në pajtim me parimet e SNK 2, inventarët deri në atë masë që janë të realizuara në formë të inventarit të prodhuar. Entiteti duhet të njeh këto kosto si “pasuri e aktivitetit blerës” deri në atë masë që përfitimet paraqesin qasje të përmirësuar në xehe, në kuadër të pasurive jo-aktuale, që i nënshtrohen përmbushjes së disa kriterëve. Ky interpretim nuk është i zbatueshëm për operacionet e Bankës.
- **Kompensimi i pasurive dhe detyrimeve financiare –Ndryshimi i SNRF 7 (publikuar në Dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2013).** Amandamenti kërkon informime të tilla, të cilat përdoruesit të pasqyrave financiare të entitetit i mundësojnë vlerësimin e efektit apo efektit potencial të rrjetit të aranzhimeve, përfshirë të drejtat e set-off. Amandamenti do të ketë një ndikim në informim mirëpo jo në matjen dhe njohjen e instrumenteve financiare. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **Kompensimi i pasurive dhe detyrimeve financiare - Ndryshimi i SNK 32 publikuar në Dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë në apo pas 1 Janarit, 2014).** Amandamenti ka shtuar zbatimin e udhëzimit SNK 32 për të adresuar mospërputhjet e identifikuar në zbatimin e disa kriterëve të kompensimit. Kjo përfshin sqarimin e domethënies së “aktualisht ka ligjërisht të drejtë të zbatojë të drejtën e set-off-it” dhe disa sisteme të marrëveshjeve bruto mund të merren parasysh ekuivalente me neto marrëveshjet. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **Ndryshimi i SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar – huatë qeveritare.** Amandamentet që kanë të bëjnë me kreditë e pranuar nga qeveritë me normë më të ulët tregu të interesit, i japin adoptuesve – të cilët për herë të parë adoptojnë SNRF – lehtësim nga zbatimi retrospektiv i SNRF kur bëjnë kontabilitetin për këto hua në tranzicion. Të lartë cekurve kjo iu jap lehtësim të njëjtë si përgatitësit ekzistues. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.

Përmirësimet në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (publikuar në Maj 2012 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë me 1 Janar, 2013). Përmirësimet përbëhen nga ndryshimet në 5 standarde. SNRF është amandamentuar për të (i) sqaruar se një entitet i cili vazhdon përgatitjen e pasqyrave të saj financiare sipas SNRF-ve, vazhdimisht mund të zbatojë IRFS 1 apo të gjitha SNRF-të retrospektivisht, sikur të mos kish rreshtur kurrë së zbatuari ato, dhe (ii) shtuar një përjashtim nga zbatimi i SNK 23, kostot e huamarrjes, retrospektivisht, nga adoptuesit për herë të parë. SNK 1 është ndryshuar për të sqaruar se shënimet shpjeguese nuk janë të nevojshme për të mbështetur bilancin e tretë të gjendjes të paraqitur në fillim të periudhës pararendëse ngase ka qenë materialisht e prekur nga ri-pasqyra retrospektive, ndryshimet në politikat kontabël apo ri-klasifikimet për qëllime prezantuese, gjersa shënimet shpjeguese kërkojnë kur entiteti vullnetarisht vendos të ofrojë pasqyra shtesë krahasimore. SNK 16 është ndryshuar për të sqaruar se pajisjet shërbyese, që shfrytëzohen për më shumë se një periudhë konsiderohen si pronë, objekte apo pajisje, e jo inventar.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT TË REJA DHE TË NDRYSHUARA (VAZHDIM)

2.3. Standardet dhe interpretimet të publikuara por që ende nuk janë në fuqi (vazhdim)

- SNK 32 është amandamentuar për të sqaruar se pasoja të caktuara tatimore të shpërndarjes të pronarët duhet të merren parasysh në pasqyrën e të hyrave, ashtu siç është kërkuar gjithmonë nga SNK 12. SNK 34 është amandamentuar për të sjellë kushtet e saj në pajtim me SNRF 8. SNK 34 kërkon zbulimin e një masë të pasurive dhe detyrimeve totale për një segment operativ, vetëm nëse informata e tillë i është dhënë rregullisht vendimmarrësit kryesor operativ dhe ka pasur një ndryshim material në ato masa që nga pasqyrat e fundit vjetore financiare. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **Amandamente për udhëzimin transitor në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12 (publikuar me 28 Qershor, 2012 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë me 1 Janar, 2013).** Amandamenti sqaron udhëzimin transitor në SNRF 10 – Pasqyrat e konsoliduara financiare. Entitetet të cilat adoptojnë SNRF 10 duhet të vlerësojnë kontrollin në ditën e parë të periudhës vjetore në të cilën SNRF 10 është adoptuar, dhe nëse përfundimi i konsoliduar nën SNRF 10 dallon nga SNK 27 dhe SIC 12, atëherë periudha komparative pararendëse (pra, viti 2012 për vitin kalendarik për entitetin i cili SNRF 10 e adopton në vitin 2013) ri-pasqyrohet, përveç nëse një gjë e tillë nuk është praktike. Amandamentet poashtu ofrojnë lehtësim shtesë transitor në SNRF 10, SNRF 11 Aranzhimet e përbashkëta dhe SNRF 12 “Zbulimi i interesave në entitetet tjera”, duke limituar kushtin për të ofruar informata komparative të përshtatura vetëm për periudhën pararendëse komparative. Amandamentet heqin kushtin për të prezantuar informata komparative për të dhëna që kanë të bëjnë me entitete me strukturë të pakonsoliduar para se SNRF 12 të zbatohet për herë të parë. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.
- **Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – Entitetet investuese (publikuar me 31 Tetor, 2012 dhe në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë me 1 Janar, 2014).** Amandamenti paraqet një definicion të entitetit investues si një entitet, i cili (i) merr fonde nga investitorët me qëllim që atyre t’ju jap shërbime në menaxhimin e investimeve, (ii) zotohet të investitorët e tij se qëllimi biznesor i tij është që fondet t’i investojë vetëm për rritje të kapitalit apo të hyrat investuese dhe (iii) matë dhe vlerëson investimet e tij në bazë të vlerës fer. Një entitet investues kërkohet të merr parasysh filialet e tij në vlerë fer përmes fitimit dhe humbjes, dhe të konsolidojë vetëm ato filiale të cilat ofrojnë shërbime që kanë të bëjnë me aktivitetet investuese të entitetit. SNRF 12 është amandamentuar për të paraqitur informata të reja, përfshirë çfarëdo gjykimi domethënës të arritur në përcaktimin nëse një entiteti është entitet investues dhe informatat për mbështetjen financiare apo mbështetje tjetër të një filiali të pakonsoliduar, qoftë të synuara apo tashmë të dhëna filialit. Banka nuk pret që amandamentet të kenë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare.

Banka ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, ndryshime dhe interpretime para datave kur ato të hynë në fuqi. Banka pret që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndonjë efekt material në pasqyrat e saj financiare në periudhën e zbatimit fillestar. Banka është duke marrë parasysh ndikimin e SNRF 9 dhe datën e zbatimit të saj fillestar.

3. PERMBLEDHJA E POLITIKAVE TE RENDESISHME TE KONTABILITETIT

3.1. Deklarata e përputhshmërisë

Banka përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahës kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (KISNRF) dhe pararendësit e tij.

Pasqyrat financiare SNRF të bankës përbëhen nga pasqyrat e gjendjes financiare, pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare.

3.2 Bazat e pregaditjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, përveç ri-vlerësimit të instrumenteve financiare. Politikat parësore kontabël janë të shpalosura si më poshtë.

3.3 Valuta funksionale

Në pajtim me SNK 21, valuta funksionale e Bankës është EUR pasi është valuta e mjedisit primar ekonomik ku banka operon dhe reflekton substancën ekonomike të ngjarjeve.

3.4 Te hyrat kamatore dhe shpenzimet

Të ardhurat nga Interesi dhe shpenzimet regjistrohen në fitim dhe humbje për të gjitha Instrumentet që sjellin interes për bazë akruale duke përdorur metodën efektive treguese.

3.5 Tarifat dhe komisionet

Të hyrat nga tarifat dhe komisionet dhe shpenzimet që rrjedhin nga dhënia, respektivisht përdorimi i shërbimeve bankare janë regjistruar në fitim dhe humbje siç kanë ndodhur, respektivisht në momentin kur janë përfshirë shërbimet, respektivisht përdoruar ato.

Tarifat e menaxhimit të kredive që ka gjasa të tërhiqen deri në fund janë shtyrë (së bashku me kostotdirekt të lidhura) dhe regjistrohen si një korrigjim i normës efektive të Interesit të kredisë.

Të ardhurat nga pagesat dhe komisionet dhe shpenzimet përfshijnë gjithashtu pagesat nga letër garancionet dhe letërkreditë e lëshuara nga Banka në favor të klientëve, detyrimet e pagesave që rrjedhin nga bankat vendase dhe ndërkombëtare, dhe shërbimet tjera të tëruara nga Banka.

3. PERMBLEDHJA E POLITIKAVE TE RENDESISHME TE KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6 Instrumentet financiare

i. Klasifikimet

Pasurit financiare klasifikohen në kategorite si në vijim: pasuri financiare të disponueshme për shitje dhe kredi dhe paradhënie. Klasifikimi i pasurive financiare përcaktohet në njohjen e tyre fillestare, varesisht nga karakteristikat e instrumentit dhe qëllimin e menaxhmentit.

Kredite dhe kërkesat janë instrumente financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktuara, që nuk janë të kuotuar në tregjet aktive.

Asetet në dispozicion për shitje janë ato që mbahet për një periudhë të pacaktuar kohore, të cilat mund të shiten në varësi të nevojave për likuiditet ose ndryshime në normat e Interesit, kurset e këmbimit ose çmimeve të ekuivalentit

ii. Matjet

Pasuritë financiare maten fillimisht me vlerë të drejtë të tyre plus kosto transaksionit, nëse ka. Kreditë dhe kërkesat regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë plus koston e transaksionit, nëse ka. Pas njohjes fillestare këto maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën efektive të Interesit. Kosto e amortizimit llogaritet duke përdorur metodën e 16set efektive të Interesit. Primet dhe zbritjet, duke përfshirë koston e transaksionit fillestar, përfshihen në vlerën kontabël të Instrumentit të ndërlidhur dhe amortizimit në bazë metodës efektive të Interesit të Instrumentit, kur është e aplikueshme.

Metoda e Interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një aseti financiar dhe të ndarjes së të ardhurave të Interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e Interesit efektiv është norma që saktësisht zbritet arkëtimet e vlerësuar të ardhshme monetare (përfshirë të gjitha pagesat në pikat e paguara ose të pranura që formojnë një pjesë përbërëse të së Interesit efektiv, koston së transaksionit dhe primeve ose zbritjeve tjera) kohëzgjatjes së pritur të asetit financiar, ose sipas rastit, një periudhë më të shkurtër.

iii. Instrumentet specifike

Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e tyre janë artikuj që mund të konvertohen në para të gatshme në afat të shkurtër (me më pak se tre muaj maturim) dhe të cilat i nënshtrohen një risku të parëndësishëm të ndryshimit të vlerës. Shumat që lidhen me fondet që janë të një natyre të kufizuar janë të përjashtuara nga paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuar.

Reserva e detyrueshme për likuiditet

Në përputhje me rregullat e BQK, Banka duhet të plotësojë kërkesat minimale të likuiditetit mesatar. Kërkesat e likuiditetit llogariten në baza javore si 10 % e bazës së depozitave, të përcaktuar si mesatare e gjithsejt të detyrimeve të depozitave për sektorin jo-bankar në valutë euro dhe valuta të tjera, gjatë ditëve afariste për periudhën e mirëmbajtjes. Asetet me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e saj të likuiditetit janë depozitat në euro me BQK dhe 50% e ekuivalentit të EUR të shprehura në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së zbatueshme të depozitave. Për shkak se asetet likuide përkatëse nuk janë në dispozicion për të

3. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

Aktivitetet financiar të përditshme të Bankës, ato janë të përjashtuara nga paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj për qëllime të pasqyrës së qarkullimit të parasë.

Asetet financiare në dispozicion për shitje

Në njohjen fillestare, asetet financiare në dispozicion për shitje regjistrohen me vlerën e drejtë plus shpenzimet e transaksionit, nëse ka. Më pas ato mbahen me vlerën e drejtë. Vlerat e drejta të raportuara janë çmimet e vëzhgueshme të tregut ose vlerat e llogaritura me një teknikë vlerësimi të bazuar në tregun. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aseteve financiare të mbajtura për shitje regjistrohen so të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse. Në pozitën “rezerva e rivlerësimit të Instrumenteve financiare në dispozicion për shitje”, deri sa aset financiar tëshlyhet nga regjistri apo të zhvlerësohet. Në këtë rast, fitimi ose humbja kumulative e regjistruar më pare në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse transferohet në ose humbje. Interesi I llogaritur duke përdorur metodën e efektive të Interesit dhe fitimet dhe humbjet në valutë të huaj në asetet që klasifikohen në dispozicion për shitje regjistrohen si Fitim ose humbje.

Kreditë dhe paradhëniet

Kreditë dhe avanset klasifikohen si kredi dhe kërkesa. Kreditë dhe kërkesat maten me kosto të amortizuar. Kosto e amortizuar e një aseti financiar ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aseti financiar ose detyrimi financiar matet në regjistrimin fillestar minus pagesat kapitale, plus ose minus amortizimi I akumuluar duke përdorur metodën e Interesit efektiv të çfarëdo difference në mes të shumës fillestare dhe shumës së maturimit, dhe mes çfarëdo reduktimi (17sset përdorimit të një llogari tëpagesave) për zhvlerësim apo pamundësi të arkëtimit. Kreditë dhe avanset raportohen si neto e shtesave për zhvlerësim të kredive për të reflektuar shumat që priten të rikthehen.

iv. Çregjistrimi

Asetet financiare nxjerrën nga bilanci kur të drejtat kontraktuale të qarkullimit të parasë së aseteve financiare skadojnë apo asetet financiare transferohen dhe transferi kualifikohet si nxjerrje nga bilanci. Transaksioni trajtohet si transfer I asetit financiar, kur të gjitha risqet dhe beneficionet a njesise transferuar. Kur banka nuk transferon dhe nuk mban të gjitha risqet beneficionet e pronësisë të asetit financiar, do të përcaktohen nëse banka do të mbajë kontrollën e aseteve financiare. Një detyrim financiar nxjerrët nga pasqyra e pozitës financiare dhe vetëm atëherë shlyhet. Kur detyrimi I specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon, respektivisht kur detyrimi I specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon.

v. Zhvlerësimi i aseteve financiare

Kreditë dhe avancet e klientëve raportohen me kosto të amortizuar të rezervave neto (shtesat) për të reflektuar shumat që vlerësohen të rikthehen. Rezerva e riskut kreditor për zhvlerësimin e kredive vendoset nëse ka një asset që Banka nuk do të jetë në gjendje të arkëtojë shumat përkatëse sipas kushteve fillestare kontraktuale. Shuma e rezervave është diferenca midis vlerës kontabël dhe shumës që vlerësohet të rikthehet. Shtesat bëhen kundër vlerës kontabël të kredive dhe avanceve që janë identifikuar si duke u zhvlerësuar në bazë të rishikimeve të rregullta të bilanceve të papaguara për të reduktuar këto kredi dhe avance për shumën e tyre të ri-kthyeshme. Shtesat për zhvlerësimin e kredisë mbulojnë edhe humbjet ku ka që humbjet e mundshme janë të pranishme në komponentët e portfolios kreditorë në datën bilancit të gjendjes. Këto llogariten në bazë të modeleve historike të humbjeve në

3. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**3.6 Instrumentet financiare (vazhdim)**

secilin asset dhe klasifikimi kreditor i caktuar për kredi pasqyron ambientin ekonomik në të cilin kredimarrësi operon. Banka së pari vlerëson nëse asseti e zhvlerësimit ekziston Individualisht për asetet financiare që janë individualisht të rëndësishme, dhe Individualisht ose kolektivisht për asetet financiare që nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton se nuk ekziston të zhvlerësimit për një asset financiar të vlerësuar Individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ajo përfshin asetin në një grup asetesh financiare me karakteristika të ngjashme të riskut kreditor dhe kolektivisht i vlerëson ato për zhvlerësim.

Asetet që janë të vlerësuar Individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat humbja nga zhvlerësimi është po vazhdon të regjistrohet nuk janë të përfshira në vlerësim kolektiv të zhvlerësimit.

Shuma e humbjes matet si diferencë midis vlerës kontabël të asetit dhe vlerës aktuale të qarkullimit të ardhshëm të parasë (duke përjashtuar humbjet e ardhshme kreditore që nuk kanë ndodhur) të zbritura me normën origjinale efektive të Interesit të asetit financiar. Vlera kontabël e asetit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie të pagesës dhe shuma e humbjes regjistrohet në fitim ose humbje.

Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit, asetet financiare grupohen në baza të karakteristikave të ngjashme të riskut kreditor (p.sh., në bazë të procesit të klasifikimit të Bankës që konsideron llojin e aseteve, në industrinë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin në të kaluarën dhe faktorë të tjerë përkatës). Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e qarkullimeve të ardhshme të parasë për grupet e asetet të tilla duke qenë tregues i aftësisë së debitorëve për të paguar të gjitha shumat në përputhje me kushtet kontraktuale të asetet që janë duke u vlerësuar.

Klasifikimi i kategorive është si në vijim:

Kategoria A- Standard

Të gjitha kreditë apo shërbimet tjera të drejtpërdrejta kreditore dhe ekspozimet jashtë bilancore që bartin një rrezik normal bankar. Informacionet në dispozicion në lidhje me ekspozimet kreditore, performansën e llogarisë së klientit, dhe të dhënat financiare që të gjitha këto dëshmojnë se shlyerja e ekspozimit është mjaft e sigurtë dhe nuk ka ndonjë vështirësi (apo obligimi është i sigurtuar plotësisht me kolateral të përshtatshëm). Kredia është aktive, apo delikuenca nuk është vonuar më shumë se tri dhjetë – 30 ditë nga data e kthimit apo maturimit të kredisë. Mbitërheqjet duhet të jenë brenda limitit të caktuar, ose vetëm përkohësisht të tejkalojnë limitin prej 5% ose më pak se 30 ditë, si dhe rrjedha e parasë në llogarinë rrjedhëse është e mjaftueshme për të shlyer bilancin e mbitërheqjes brenda 30 ditëve nga data e skadimit të mbitërheqjes.

Kategoria B- Vëmendje e posaçme (ose Vrojtuese) – Ky klasifikim duhet të përdoret për të identifikuar dhe monitoruar ekspozimet që përmbajnë dobësi apo dobësi potenciale të cilat në rastin e rishqyrtimit, nuk e rrezikojnë kthimin e kredisë apo nuk reflektojnë ndonjë potencial për ndonjë humbje, por të cilat, po qe se nuk adresohen apo nuk korrigjohen mund të rezultojnë në keqësimin e kredisë në nën standard apo klasifikim më të ashpër. Në rast se ka mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar që është e pafavorshme, apo këto kredi vonohen më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë atëherë bankat duhet t'i klasifikojnë këto kredi si “Kredi me vëmendje të posaçme”, si dhe ato kredi që janë vazhdimisht në mbetje të borxhit në tejkallim të 5% të linjave të aprovuara për më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë. Kjo kategori e klasifikimit është përpiluar që t'ju mundësojë bankave që të identifikojnë dhe adresojnë marrëdhëniet shumë të dobëta që në fazën e hershme.

3. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

Kategoria C - Nën-standard - Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, janë definuar qartë dobësitë e kredisë të cilat rrezikojnë pagesën e kredisë në një kurs normal. Një kredi Nën Standard është ajo kredi e cila në bazë të analizave të të dhënave financiare si dhe faktorëve të tjerë, nuk është e mbrojtur për momentin nga vlera e shëndoshë si dhe nga kapaciteti i pagesës së huamarrësit apo garantuesit ose vlera e kolateralit. Kërkohe mbështetje nga ana e garantuesve përgjegjës dhe të aftë për të kthyer kredinë gjë që do të përfshinte edhe negociata të vazhdueshme para se likuidimi i kredisë të kërkojë një klasifikim Nën standard. Nevoja për të kërkuar mbështetjen e kolateralit si mjet për të shlyer obligimin duhet të jetë bazë për një klasifikim Nën Standard.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet Nën Standard, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 60 ditëve që nga data e skadimit të kredisë.
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 60 ditë pa e paguar këtë tejkalim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të paguar këstet e kredisë sipas kontratës (duke përfshirë edhe interesin) për më tepër se 60 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 60 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria D-Dyshimtë

Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, përmbajnë të gjitha dobësitë të cilat janë të qenësishme në kreditë Nën Standarde, por të cilat theksojnë që ekzistojnë mundësitë e forta që pjesa e rëndësishme e shumës së këstit nuk do të paguhet. Ka mundësi të humbjes, mirëpo shuma e saktë nuk mund të definohet saktësisht në rastin e shqyrtimit apo kjo varet edhe nga shfaqja e ndonjë veprimi apo rasti në të ardhmen. Ndonëse mundësia e humbjes është jashtëzakonisht e lartë, për shkak të faktorëve të rëndësishëm dhe të pazgjidhur specifik, por të cilët mund të funksionojnë për të mirën dhe përforcimin e kredisë, klasifikimi i saj si humbje e përafërt mund të shtyhet deri sa të përcaktohet një status më i saktë. Shembuj të faktorëve të tillë përfshihen por nuk janë të limituar në bashkimin, përvetësimin, ristrukturimin e kapitalit, si dhe furnizimin me kolaterale të reja apo plane të reja të rifinancimit. Garantuesve që nuk bashkëpunojnë apo atyre që janë në një gjendje të dobët financiare nuk duhet të konsiderohen si të aftë për të mbështetur kredinë.

Mbështetje në çfarëdo kolaterali të disponueshëm që nuk do të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar shumën gjithashtu mund të arsyetojnë klasifikimin e dyshimtë.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet si i dyshimtë, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 90 ditëve që nga data e skadimit.
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 90 ditë pa e paguar këtë tejkalim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 90 ditë.

3.PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

v. Zhvlerësimi i aseteve financiare (vazhdim)

- (d) Nëse ka mungesë në gjendjen financiare të klientit që ka shkaktuar kapital negativ.
- (e) Nëse afati i kthimit/përfundimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 90 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria E- Kredit e këqija (humbje) –janë ato ekspozimet të cilat të bazuara mbi një analizë të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, kanë vlerë të vogël ose do të kërkojnë një periudhë shtesë për të realizuar ndnjë vlerë dhe nuk janë më të arsyeshme që të mbahen në librat aktive të bankës.

Një ekspozim mund të konsiderohet si i ekspozim i keq (humbje) nëse ndonjë nga kriteret në vijim aplikohet:

- (a) Nëse depozitat/rrjedha e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e mbitërheqjes të papaguar brenda 180 ditëve nga data e skadimit të mbi tërheqjes.
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar të kredisë mbi 5% apo më shumë për mbi 180 ditë pa e paguar këtë mbitërheqje apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 180 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit/data e skadimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 180 ditë për arsye të mospagimit.
- (e)

Zhvlerësimet dhe rezervat për pjesën e mbetur të portfolios së ndërmarrjeve, pronarëve të vetëm dhe klientëve të retail (kërkesat nga klientët që nuk janë Individualisht të rëndësishëm) dhe për kërkesat ngaklientët Individualisht të rëndësishëm (përveç bankave) për të cilët nuk ka asnjë provë të zhvlerësimit, llogariten në baza grupore (qasja e porttëolios). Kreditë në grup janë të ndara më tej në kategoritë, Ndërmarrje dhe pronarë të vetëm, grupe të klientëve të retail në bilancin e gjendjes. Të gjitha të tri grupet më tej ndahen në pesë nën kategoritë A, B, C, D, dhe E.

Kur një kredi konsiderohet e pa-arkëtueshme, ajo është shlyhet me rezervat përkatëse për zhvlerësimin kreditor. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e nevojshme të kenë përfunduar dhe shuma e humbjes të jetë përcaktuar. Rikthimet pasuese të shumave të shlyera më parë kreditohen në fitim ose humbje.

Nëse shuma e rezervës për zhvlerësimin e kredisë më pas zvogëlohet për shkak të një ngjarje që ndodh pas shlyerjes, lirimi i rezervave kreditohet në fitim të humbjes.

Asetet financiare të mbajtura për shitje - Banka vlerëson në çdo datë të bilancit të gjendjes nëse ka evidencë objektive që asetet financiare në dispozicion për shitje janë zhvlerësuar. Në rast të Investimeve të kapitalit të klasifikuara si të disponueshme për shitje, rënia e konsiderueshme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të asetit nën koston e tij konsiderohet si një evidencë objektive e zhvlerësimit. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston, humbja kumulative largohet nga të ardhura tjera gjithëpërfshirëse dhe regjistrohet në fitim dhe humbje. Humbjet nga zhvlerësimet të regjistruara në fitim dhe humbje të Instrumentave të kapitalit nuk kthehen nëpërmjet fitimit dhe humbjes; rritja e mëpasshme e vlerës së drejtë pas zhvlerësimit regjistrohen në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

3. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

v. Zhvlerësimi i Mjeteve financiare (vazhdim)

Nëse, në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë e një pasurie financiare të disponueshme për shitje si në dispozicion për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi është regjistruar humbja nga zhvlerësimi. Në fitim dhe humbje, humbja nga zhvlerësimi rikthehet përmes fitimit dhe humbjes.

Faktorët e mëposhtëm konsiderohen në përcaktimin e humbjeve nga zhvlerësimi për Instrumentet debitoare:

- Vonesa ose mospagesa të Interesit ose kryegjësë së pagesave;
- Vështirësitë likuide të emetuesit;
- Shkelja e termeve dhe kushteve të kontratës;
- Falimentimi i emetuesit;
- Përkeqësimi i kushteve ekonomike dhe të tregut dhe
- Përkeqësimi Në klasifikimin kreditor të emetuesit. Në nivel të pranueshëm

Humbjet nga zhvlerësimet e regjistruara në fitim dhe humbje maten si diferenca e mes të vlerës bartëse të asetit financiar dhe vlerës aktuale të tij të drejtë. Vlera aktuale e drejtë e Instrumentit është çmimi i tij në treg ose qarkullimet e parasë së ardhshme të zbritura, kur çmimi i tregut nuk është i arritshëm.

3.7 Valutat e huaja

Transaksionet në valutë të huaj përpos në EUR këmbehen në valutë funksionale me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transaksionit. Fitimet në valutë të huaj dhe humbjet që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve të tilla dhe nga këmbimi i aseteve dhe detyrimet monetare. Në valutë të huaj regjistrohen si fitim dhe humbje (si fitimet dhe humbjet të këmbimit valutor).

Zërat jo-monetar, që maten në aspektin e kostos historike në një valutë të huaj nuk ri - konvertohen.

3.8 Pasuritë afatgjata materiale

Pronat, ndërtesat dhe pajisjet janë paraqitur me kosto më të ulët të amortizimit të akumuluar për humbje, ku kërkohet. Çdo vit, Banka vlerëson nëse ka indikacione që asetet mund të jenë të dëmtuara. Nëse ndonjë indikacion i tillë ekziston, shumat e rikthyeshme duhet të vlerësohen. Shuma që vlerësohet e rikthyeshme është lartësia e vlerës së drejtë të një asemi minus kosto e shitjes dhe vlera e saj-në-përdorim. Kur vlera kontabël e një pasurie është më e madhe se shuma e vlerësuar për arkëtim, ajo shlyhet deri në shumën e arkëtueshme dhe ndryshimi i ngarkohet fitimit ose humbjes. Fitimet dhe humbjet me rastin e shitjes/shlyerjes së pronës, ndërtesave dhe pajisjeve janë të përcaktuara duke u referuar vlerës kontabël dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën. Riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit ose humbjes kur shpenzimi ka ndodhur. Zhvlerësimi ngarkohet duke përdorur metodën lineare, mbi kohëzgjatjen e vlerësuar të çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Për amortizimin e mëtejshëm ngarkohet pas muajit të blerjes, ndërsa për shitjet e ri në muajin e shitjes zhvlerësimi nuk fillojnë deri sa asetet të jenë në dispozicion për përdorim.

3. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Normat vjetore të amortizimit të përdorura për çdo kategori të pronës, ndërtesave dhe pajisjeve janë si në vijim:

Kategoria e asetëve	Perqindja e amortizimit të përdorur
Ndërtesat	5%
Renovimi i objekteve të marra me qira	Më e ulët se koha e qirasë apo 20%
Mobile, Instalime dhe pajisje	20%
Kompjuterë dhe pajisje shtesë	20%
Automjete motorike	20%

3.9 Pasuritë afatgjata jo materiale

Pasuritë e paprekshme të marra nga Banka paraqiten me kosto më të ulët të akumuluar të amortizimit he humbjeve, kur kërkohet. Amortizimi është dhënë në bazë lineare në një normë vjetore prej 20%. Shpenzimet e mëtejme në pasuritë kapitalizuara të paprekshme kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me pasuritë e veçanta me të cilat ka lidhje. Të gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen siç janë shkaktuar. Amortizimi nuk fillon deri sa asetet të jenë në dispozicion për përdorim.

3.10 Pasuritë financiare të mbajtura për shitje

Pasuritë jo-xhiruese janë klasifikuar si të mbajtura për shitje në qoftë se shuma e tyre mbajtëse do të mbulohet kryesisht përmes një transaksioni shitjeje në vend se përmes përdorimit të vazhdueshëm. Ky kusht konsiderohet i përmbushur vetëm kur shitja është shumë e mundshme dhe pasuria është në dispozicion për shitje të menjëhershme në gjendjen e saj aktuale. Menaxhmenti duhet të jetë këmbëngulës në shitje, e cila mund të pritët të kualifikohet për njohje si një shitje e përfunduar Brenda një viti nga data e klasifikimit.

Pasuritë jo-xhiruese të klasifikuara si të mbajtura për shitje maten me shumë më të ulët se ajo e mëparshme dhe vlera e tregut duke zbritur koston për shpenzime të shitjes.

3.11 Pasuritë e konfiskuara

Pasuritë e konfiskuara përfaqësojnë asetet financiare dhe jo-financiare të konfiskuara nga Banka për shlyerjen e kredive të vonuara. Asetet regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë kur konfiskohen dhe përfshihen në ndërtesat dhe pajisjet, asetet tjera financiare ose inventaret brenda asetëve tjera në varësi të natyrës së tyre dhe qëllimit të Bankës në lidhje me rikthimin e këtyre asetëve, dhe më pas rivlerësohen dhe llogariten për në përputhje me politikën kontabël për këto kategori të asetëve.

3.12 Zhvlerësimi i asetëve jo-financiare

Një zhvlerësim i humbjes regjistrohet kur vlera kontabël e një aseti e tejkalon shumën e arkëtueshme. Shuma e arkëtueshme e asetit është më e lartë nga çmimi neto i shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorimin e një aseti është vlera aktuale e qarkullimit të parashikuar të parasë në të ardhmen që pritët nga përdorimi i vazhdueshëm i një aseti dhe nga shitja e tij.

4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.13 Detyrime ndaj bankave

Detyrime ndaj bankave janë të regjistruara kur paratë ose asetet tjera janë dhënë avanc në bankë nga bankat palëve tjera. Detyrimet jo-derivative realizohen me kosto të amortizuar.

3.14 Detyrime ndaj klientëve

Detyrime ndaj klientëve janë detyrimet jo-derivative ndaj individëve, shtetit, apo klientëve korporata dhe mbahen me kosto të amortizuar.

3.15 Huamarrjet

Huamarrjet regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, duke marrë parasysh vlerën reale/tregut dhe duke zbritur shpenzimet e transaksionit. Huamarrjet janë paraqitur më pas me kosto të amortizuar. Çdo interes ose taksë që lidhet me fondet e huazuara është paraqitur në fitimin ose humbjen për periudhën.

Kostot e huamarrjes që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi të kualifikuar janë të pranura si pjesë e kostos së këtij aktivi. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes pranohen si shpenzim në periudhën në të cilën ai ndodh.

3.16 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim për vitin aktual llogaritet në bazë të rregullave të tatimit mbi të ardhurat në fuqi në Kosovë, duke përdorur normat në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Në fuqi nga data 1 janar 2010, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 10 %, në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht Në fuqi, ligji nr. 03/L-162 “ TatimNë mbi të ardhurat e Korporatës”. Paga e tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përmban tatimin aktual, të periudhës dhe ndryshimet në tatimet e shtyra. Tatimi aktual/i periudhës llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Fitimi I tatueshëm ndryshon nga fitimi siç është raportuar në bilancin e suksesit sepse përjashton zëra të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose zbritshme në vitet e tjera dhe më tej përjashton zëra që nuk janë të tatueshme ose zbritshme. Tatimet tjera përpos tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative. Tatimi në të ardhurat e shtyra llogaritet duke përdorur metodën e bilancit të detyrimeve për të gjitha diferencat e përkohshme që rrjedhin në mes bazës tatimore të aseteve dhe detyrimeve dhe shuma e tyre mbajtëse për qëllime të raportimit financiar. Tatimet në të ardhurat e shtyra janë të përfshira deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Tatimet në të ardhurat e shtyra ulen deri në atë masë që nuk është më e mundshme që të realizohet përfitimi në lidhje me tatimin. Tatimi në pasuritë e shtyra dhe detyrimet maten me norma tatimore që pritet të zbatohet për periudhën kur pasuria realizohet ose detyrimi është i vendosur në bazë të normave të taksave që kanë qenë në fuqi ose në nën-fuqi në datën e bilancit. Tatimi në pasuritë e shtyra dhe detyrimet kompensohet kur ekziston e drejta e ekzekutueshme ligjërish për të vendosur tatimin aktual të pasurisë kundër detyrimeve tatimore dhe kur ato kanë të bëjnë me të ardhurat e mbledhura nga autoriteti i njëjtë tatimor.

3. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.17 Angazhimet e zërave jashtë-bilancor dhe ngjarjet e paparashikuara

Në kursin e zakonshëm të afarizmit të saj, Banka ka hyrë në zotime jashtë-bilancore si garancione, zotime për zgjatje të kredive dhe letër kredive dhe transaksioneve me Instrumente financiare. Provizionit për humbjet në zotime dhe detyrime kontingjente/te mundshme mbahet në një nivel adekuat për të absorbuar humbjet e mundshme në të ardhmen. Menaxhmenti përcakton përshtatshmërinë e provizionit bazuar mbi rishikimin e zërave individual, historikut të humbjeve të fundit, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të kategorive të ndryshme të transaksioneve dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm.

Kontratat e garancioneve financiare janë kontrata që kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për humbjen që ka pësuar për shkak se një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesat në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e një Instrumenti debitor. Garancionet e tilla financiare janë dhënë bankave, institucioneve financiare dhe organeve tjera në emër të klientëve për të siguruar kredi, mbitërheqje dhe produkte të tjera bankare.

Garancionet financiare në datën e lëshimit regjistrohen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e pagesës së pranuar. Pagesa amortizohet në fitimin dhe humbjen gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimeve të bankës sipas garancioneve më pas maten me: matjen fillestare, amortizimi i zbritur i llogaritur për të regjistruar të ardhurat gjatë periudhës së garancionit ose vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin.

Garancionet për përfundim/kompletim - janë kontrata që kërkojnë nga emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje të pësuar për shkak se një debitor specifik nuk arrin të përfundojë punën me kohë, në përputhje me kushtet e kontratës.

Garancionet në datën e emetimit regjistrohen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e pagesës së pranuar. Pagesa amortizohet në fitimin dhe humbjen gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimeve të bankës sipas garancioneve më pas maten me:

- Matjen fillestare, amortizimi i zbritur i llogaritur për të regjistruar të ardhurat gjatë periudhës së garancionit
- Vlerësimin më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin

3.18 Provizionet

Rezervimet regjistrohen kur Banka ka një obligim të tanishëm ligjor ose konstruktiv, si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një qarkullim i burimeve që përmban përfitim ekonomike do të nevojitet që të zgjidhin detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimeve. Rezervimet maten me vlerësimin më të mirë të menaxhmentit për shpenzimet e nevojshme për të zgjidhur detyrimin në datën e pasqyrës së bilancit dhe zbriten në vlerën aktuale ku efekti është material.

3.19 Përfitimet e të punësuarve

Banka paguan kontribute për planin pensional të administruar publikisht (TKPK) në baza të obligueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që kontributet të paguhen. Kontributet regjistrohen si shpenzime për përfitim të punësuarve atëherë kur ato duhet të paguhen.

3.20 Qiratë operative

Pagesat e bëra për qiratë operative i ngarkohen shpenzimeve mbi një bazë linerare gjatë afatit të qirasë. Kur një qira operativ ndërprehet para të mbarojë periudha e qirasë, çdo pagesë kërkohet të bëhet qiradhënës si penalti/dënim regjistrohet si shpenzim në periudhën në të cilën ka ndodhur ndërprerja.

3. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.21 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Në zbatimin e politikave të Bankës për kontabilitet, që përshkruhen në shënimin 3, menaxhmenti duhet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël regjistrohet në periudhën në të cilën vlerësim është rishikuar. Nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat eardhshme, nëse rishikimi ndikon në të dyja periudhat aktuale dhe të ardhshme.

a) Zhvlerësimi i kredive të klientëve

Për të përcaktuar Nëse kreditë për klientët janë zhvlerësuar mbi baza Nëdividuale kërkon vlerësim Në e vlerës aktuale të qarkullimit të pritshëm të parasë nga kreditë e klientëve duke përfshirë shumat e arkëtueshme nga garancionet dhe kolateral Në. Menaxhmenti i Bankës është duke përdorur gjykimin në vlerësimin e qarkullimit të pritshëm të parasë nga portfolio kreditore. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e aftësisë kreditore të klientit janë të bazuara në pozitat financiare, prëitabilitetin, pjesët në treg, dhe vlerën e kolateralit. Në mënyrë të ngjashme rrethanat që mbizotërojnë në rajonin e klientit merren në konsideratë, të tilla si: efikasitetin gjyqësor etj, ku vlera neto aktuale e qarkullimit të parasë ndryshon për + / -1%, humbja nga zhvlerësimi do të vlerësohet 211 mijë Euro më e ulët ose 188 mijë EUR më e lartë (2011: 188 mijë EUR).

4. PARAJA E GATSHME DHE GJENDJA ME BANKAT

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
Paratë e gatshme	9,954	9,250
Paratë Në banka – llogaritë rrjedhëse Në bankat korrespondente	8,995	11,077
Parate e gatshme ne dispozicion dhe ne banka	18,949	20,327

Më 31 Dhjetor, 2012 shumat Në llogari rrjedhëse me bankat korrespondente ishin EUR 8,995 mijë dhe bartin interes të ndryshëm nga 0.15% to 0.299%.(2011: EUR 11,077 mijë).

4.1 PARATË DHE EKUVALENTËT E SAJ

Paratë dhe ekuivalentet e saj në pasqyrën e qarkullimit të parasë përbëhen:

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2012
Paratë e gatshme dhe në banka	18,949	20,327
Bilanci i pakufizuar me BQK	35,843	9,810
Depozitat me maturim më pak se 3 muaj (shënimi 6)	45,084	92,171
Paratë dhe ekuivalentët e saj	99,876	122,308

5. GJENDJA ME BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS

Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës ("BQK") në shumën prej Euro 51,456 mijë me datë 31 Dhjetor, 2011 (me datë 31 Dhjetor, 2011: Euro 21,872 mijë) paraqet rezervën e detyrueshme që duhet mbajtur nën rregullat e BQK-së BQK-ja paguan. deri në shumën e plotë të kërkesës së rezervës minimale të likuiditetit (siç është përcaktuar Në shënimNë 3.6(iii)). Gjatë vitit 2012 është paguar Interes Në normën variable prej 0.1% dhe 0.6% vjetore (2011: 0.1% dhe 0.6%p.a.). Bilanci i rezervës së kufizuar të likuiditetit me BQK përjashtohet nga paraja dhe ekuivalentet e saj për qëllim të pasqyrës së qarkullimit të parasë.

Banka Qendrore e Kosovës nuk posedon klasifikim të jashtëm kreditor.

6. KREDITË DHE PARADHËNJET PËR BANKAT

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
Depozitat e afatizuar	48,706	92,103
Depozitat Në banka të likuiduara	742	742
Rezervimet për zhvlerësime	(742)	(742)
Interesi i përlogaritur	14	68
Gjithsejt kreditë dhe avancet ndaj bankave tjera	48,720	92,171
Afatshkurtër	48,720	92,171

Depozitat tek banka ne likuidim paraqet shumën e depozitave tek Banka Kreditore e Prishtines e cila më 13 Mars 2006 ka shkuar në likuidim pas tërheqjes së licencës nga BQK.. Gjatë vitit 2012, Banka nuk ka pranuar asnjë shume (2011: 38 mijë euro).

Sipas datës 31 Dhjetor, 2012 të përfshira në gjithsejt depozitat e afatizuara janë 6,950 mijë që janë fonde peng për aktivitetet e Afarizmit Financiar (2011: EUR 7,7166 mijë).

7. KREDITE DHE PARADHËNJET PËR KLIENTËT

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
Kredite e klienteve	197,048	171,803
Mbiterheqjet	57,397	55,396
Kreditë kartelat	742	235
Tjera	68	-
	255,255	227,434
Provizionet për zhvlerësim të kredive të klienteve	(21,117)	(19,136)
Gjithsejt kredite e klienteve	234,138	208,298
Afatshkurtër	114,332	64,567
Afatgjatë	119,806	143,731

Mbiterheqjet përfaqësojnë kredi suazore afat-shkurtra dhe kredi konsumuese

Lëvizja në shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë është si në vijim:

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
Provizionet për zhvlerësim të kredive më 1 Janar	19,136	18,068
Ndryshimet gjatë vitit	1,981	1,068
	-	
Provizionet për zhvlerësim të kredive më 31 Dhjetor	21,117	19,136

Zhvlerësimi i ngarkuar fitimit dhe humbjes është detajuar më poshtë:

	December 31, 2012	December 31, 2011
Provizioni I vitit	1,981	1,068
Kreditimi tek te hyrat nga interesi	(37)	(101)
Kthimet nga shlyerjet e kredive	(150)	(152)
Provizioni i ngarkuar I vitit në fitim ose humbje	1,794	815

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor, 2012

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

7. KREDITE DHE PARADHËNJET PËR KLIENTËT

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor 2011
Provizioni i ngarkuar per persona fizik:		
Kredi banesore	130	106
Kredi konsumuese	(4)	(10)
Kredi tjera individuale	107	78
	233	174
Provizioni i ngarkuar per subjekte juridike:		
Kredi per subjekte juridike		
Kredi per ndermarrje te vogla dhe te mesme	1,652	956
Kredi per subjekte te medha	96	(62)
	1,748	894
Gjithsejt	1,981	1,068

Një analizë e industrisë së portfolios bruto të kredive për klientët e korporatave para provizioneve është si në vijim:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
	%	%
Afarizëm dhe tregti	28	49
Shërbime dhe prodhim	8	19
Ndërtimtari	9	17
Tjera	55	15
	100	100

Sipas datës 31 Dhjetor, 2012, 10 kredimarrësit kryesor përbëjnë 15.1% (2011: 14.9%) të totalit të portfolios kreditore.

Te perfshira ne kredite e klienteve jane kredite e janë të përfshira individualisht te klienteve me nje gjendje prej 20,569 mije EUR sipas dates 31 Dhjetor 2012 (2011: 22,862 mije EUR).

8. HUMBJET DHE PROVIZIONET TJERA

Pagesa e dëmtimit të fitimit dhe humbjes është detajuar më poshtë:

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
Pagesa nga zhvlerësimi për fondet e keqpërdorura	56	998
Pagesa nga zhvlerësimi për Asetet e konfiskuara (shlyera)	81	35
Rezerva për garancione	(223)	44
Rezerva për raste ligjore	-	185
Lirimi i rezervave nga viti i kaluar	-	(258)
Pagesa e fitimit dhe humbjes	(86)	1,004

Pagesa e dëmtimit për fonde të keqpërdorura paraqet një mashtrim që rezulton nga bashkëpunimi në mes të punësuarve në tri degë: të Prizrenit (Nën-dega Theranda), Gjilan dhe Prishtinë. Aktakuza është dërguar në gjykatë për ish-të punësuarit për shkak të mashtrimit të tillë. Më 31 dhjetor 2012 shuma e keqpërdorur është rreth 56 mijë EUR (31 Dhjetor 2011 998 mijë EUR). Banka është e siguruar për "pandershmëri të punëtorëve" Në kompaninë e sigurimeve "Sigkos" që është e ri-siguruar në kompaninë e sigurimeve Lloyds. Banka pret që në të ardhmen të kthejë prapa humbjen e tillë dhe kthimi i tillë do të regjistrohet në të ardhura në momentin e kthimit.

9. PASURITË FINANCIARE TË MBAJTURA PËR SHITJE

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
Bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Sllovenisë	38,966	-
Bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Kosovës	18,914	-
Bono thesari ne shtetet OECD	-	35,112
NLB Montenegro Banka Obligacioni	503	503
Gjithsejt pasurite financiare te mbajtura per shitje	58,383	35,615
Afat-shkurtër	58,383	35,115
Afat-gjatë	-	500

Asetet financiare në dispozicion për shitje 58,383 mijë EUR sipas datës 31 dhjetor 2012 (2011: 35,615 mijë EUR) paraqesin bono të thesarit të qeverive (Sllovenisë dhe Kosovës) duke përfshirë letrat me vlerë debitore të emetuara nga Banka NLB Montenegro . Bono thesari të qeverisë janë me maturitet prej 10 janar 2013 deri me 13 qershor 2013 me yields prej 0.80% ne 2.00% (Bono thesari nga Sllovenia). Ndërsa ajo e NLB Montenegro në shumën prej 500 mijë EUR ka një maturim deri më 22 Nëntor 2013 me normë Interesi fikse 6.5%. Rezerva e rivlerësimit sipas datës 31 dhjetor 2012 është EUR 247 mijë (2011: EUR 6 mijë). Të gjitha pasuritë financiare të mbajtura për shitje janë me normë fikse të Interest.

Nga totali i Investimeve, Bonot në shumë prej 16,500 mijë EUR janë lënë peng në favor të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) për bazën e tyre e depozitave Në Bankë. Ky peng shërben si një siguri në favor të TKPK-së për kërkesat ekzistuese dhe të ardhshme, nëse ka, deri sa të gjitha pretendimet të shlyhen.

10. PASURITE TJERA

	31 Dhjetor, 2012	31 Dhjetor, 2011
Shpenzime të parapaguara	456	258
Kolaterali i konfiskuar ne kreditë e pashlyeshme	77	-
Kërkesat tjera	61	82
Gjithsejt asetet tjera	594	340
Afat-shkurtër	594	340

NLB PRISHTINA SH.A.
SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE NE PERPUTHJE ME STANDARDET NDERKOMBETARE PER RAPORTIM
Per vitin e perfunduar me 31 Dhjetor, 2012
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse është deklaruar ndryshe)
11. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Ndertesat	Permireshimet per qiradhenie	Mobilerite dhe pajisjet	Kompjuteret dhe pajisjet e lidhura	Puna ne progres	Veturat motorike	Gjithsejt
Kostoja:							
Sipas datës 1 Janar , 2011	3,271	815	3,505	1,428	870	587	10,476
Shtesat gjatë vitit	-	243	317	259	1,764	30	2,613
Shlyerjet	(18)	(40)	(81)	(90)	-	(15)	(244)
Sipas datës 31 Dhjetor, 2011	3,253	1,018	3,741	1,597	2,634	602	12,845
Shtesat gjatë vitit	5	79	185	102	3,814	-	4,185
Ërite tëfs/disposals	(7)	(106)	(306)	(172)	-	(14)	(605)
Sipas 31 Dhjetor, 2012	3,251	991	3,620	1,527	6,448	588	16,425
Amortizimi i akumuluar:							
Sipas datës 1 Janar, 2011	826	502	2,223	1,119	-	419	5,089
Detyrimi për vitin	173	96	453	141	-	72	935
Shlyerjet	(5)	(24)	(81)	(89)	-	(15)	(214)
Sipas 31 Dhjetor, 2011	994	574	2,595	1,171	-	476	5,810
Detyrimi për vitin	163	96	443	140	-	72	914
Shlyerjet	(5)	(105)	(305)	(165)	-	-	(580)
Sipas 31 Dhjetor, 2012	1,152	565	2,733	1,146	-	548	6,144
Vlera e regjistruar Neto:							
Sipas 31 Dhjetor, 2011	2,259	444	1,146	426	2,634	126	7,035
Sipas 31 Dhjetor, 2012	2,099	426	887	381	6,448	40	10,281

ASETET E PAPREKSHME

Softveri

Kostoja:

Sipas datës 1 Janar 2011	1,624
Shtesat	171
Shlyerjet gjatë vitit	-
Sipas 31 Dhjetor, 2011	1,795

Shtesat	207
Shlyerjet	-
Sipas 31 Dhjetor, 2012	2,002

Amortizimi i akumuluar:

Sipas datës 1 Janar 2011	1,059
Shpezimi për vitin	170
Shlyerjet gjatë vitit	-
Më 31 Dhjetor, 2011	1,229

Shpenzimi për vitin	177
Më 31 Dhjetor, 2012	1,406

